



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Financë Bankë
(shqip)”**

Universiteti “EPOKA”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Asoc. Dr. Artur RIBAJ

Prof. Asoc. Dr. Rezarta PERRI

Tetor , 2020

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Për Programin e studimit: Bsc në "Financë Bankë"(shqip)

1	IAL aplikues:	Universiteti "Epoka"
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Financë-Bankës
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bsc në Financë Bankë (shqip)
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Shkresë MASH me Nr. 1983 Prot, datë 04.04.2011
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Urdhër Nr. 312, datë 27.07.2012
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr. 565, datë 22.11.2011
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA Nr. 76, datë 21.09.2017
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	22 PAE / 12 PAK
18	Numri i studentëve:	71 studentë
19	Komente / të tjera:	-

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti "EPOKA" është një institucion privat i arsimit të lartë në Shqipëri i themeluar në bazë të vendimit Nr. 281, datë 12.03.2008, të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Akreditimi i parë institucional Universitetit "EPOKA" i është dhënë në zbatim të Urdhërit Nr. 260, datë 07.06.2011, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Shqipërisë, bazuar në dispozitat e legjislacionit shqiptar të arsimit të lartë. Universiteti "EPOKA" ka marrë akreditimin institucional periodik në bazë të Vendimit Nr. 92, datë 20.10.2017, të Bordit të Akreditimit.

Në vitin 2016, Universiteti "EPOKA" për të siguruar përputhshmëri të plotë me dispozitat e Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", ka hartuar një Statut i ri i cili është miratuar në bazë të Urdhërit të Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 146, datë 31.03.2017 dhe më pas është implementuar nga organet kompetente të Universitetit.

Programi i studimit Bachelor në Financë-Bankë (shqip) i Universitetit "EPOKA" ofrohet nga Departamenti i Financë -Bankës i cili është pjesë e Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Administrative, një nga tre Fakultetet e Universitetit Epoka. Në përputhje me Legjislacionin e Arsimit të Lartë në fuqi, programi i studimit Bachelor në Financë -Bankë (shqip) filloj të ofrohej me një kohëzgjatje normale të studimeve prej katër vitesh akademike (240 ECTS) bazuar në korrespondencën e shkresës me Nr. 1983 Prot., datë 04.04 .2011 i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Akreditimi i parë i këtij programi studimi mban datën 7.06.2011, në bazë të Urdhrit Nr.260, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

Për të përafuar programet e studimit me sistemin e Bolonjës dhe për të promovuar lëvizjen e studentëve brenda dhe jashtë vendit, Senati Akademik i Universitetit "EPOKA" përmes vendimit të tij Nr.2, datë 28.09.2011, vendosi të riorganizojë ciklin e parë të studimeve Bachelor në Programin Financë-Bankë (shqip) nga një program studimi prej katër vitesh akademike (240 ECTS) në një Bachelor në Financë-Bankë me një kohëzgjatje normale të studimeve prej tre (3) vitesh akademike (180 ECTS), në zbatim të Ligjit Nr. 10307, datë 22.07.2010 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar ". Në këtë kontekst, në bazë të Urdhrit të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 312, datë 27.07.2012, Bachelori në programin e studimit Financë-Bankë (shqip) me një kohëzgjatje normale prej katër vitesh studime akademike (240 ECTS), u riorganizua në Program studimi Bachelor në Financë-Bankë (shqip), me një kohëzgjatje normale të studimeve prej tre (3) vitesh akademike (180 ECTS).

Cikli i parë i studimit, Bachelor në Financë-Bankë (shqip) ka marrë akreditimin bazuar në vendimin Nr.76, datë 21.09.2017 të Bordit të Akreditimit.



SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr. 76, datë 21.09.2017

1. Të rritet numri i stafit akademik të brendshëm të angazhuar në realizimin e këtij programi studimi, për garantimin e mbulimit të lëndëve në gjuhën shqipe;
2. Të përfshihet në planin mësimor të këtij programi studimi praktika profesionale në veprimtari e detyrueshme;
3. Të sigurohet literaturë në shqip e plotë për të gjitha lëndët e këtij programi studimi;

II. Plotësimi i tyre nga Institucioni

1. **Rekomandimi është përmbushur plotësisht**, pasi bazuar në të dhënat e tabelave të depozituara nga IAL për 3 vitet e fundit akademike 2017-2020 konstatojmë se departamenti i Financë - Bankës që është njësi bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit Bachelor në Financë Bankë ka shtuar staf akademik efektiv (PAE), dhe konkretisht në vitin akademik 2017-2018 ka pasë 4 PAE me grada shkencore, ndërsa në vitet akademike 2018-2019 dhe 2019-2020 janë 6 PAE me grada shkencore. Stafi i ri i punësuar nga Institucioni ka kombësi shqiptare dhe mundëson kryerjen e lëndëve mësimore në gjuhën shqipe.
2. **Rekomandimi është përmbushur kryesisht**, pasi praktika profesionale është përfshirë si lëndë me zgjedhje dhe jo e detyrueshme në kurrikulën e këtij programi studimi. Në vitin e fundit akademik, vetëm 60% e studentëve e kanë kryer këtë lëndë. Për vitet e ardhshme akademike, me vendim të Senatit Akademik të UE, praktika profesionale do të jetë lëndë e detyrueshme për këtë program studimi.
3. **Rekomandimi është përmbushur kryesisht**, pasi konstatojmë se në syllabuset e lëndëve të programit të Studimit Bachelor në Financë Bankë (shqip) si literaturë e detyrueshme në një pjesë të lëndëve, mbeten ende tekste të huaja të pa përkthyer në shqip.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Në kuadër të “Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit, 2017” në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në përputhje me “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë, Universiteti Epoka, ka aplikuar për nisjen e procedurës së akreditimit të programit Bachelor në "Financë-Bankë (shqip)", nëpërmjet shërbimit në AMS në datën 30.05.2019.

ASCAL bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga UE, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm.

Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje: Prof. Asoc. Rezarta Perri, dhe Prof. Asoc. Artur Ribaj. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL, Znj. Majlinda Demirneli.

Pas komunikimit, ekspertëve të jashtëm ju vendos në dispozicion i gjithë dokumentacioni i dorëzuar nga institucioni për vlerësim. Pas një kohe në dispozicion të ekspertëve për të studiuar dokumentat dhe për të përpiluar pyetjet apo paqartësitë e tyre, u përcaktuan edhe datat e vizitave në institucion, përkatësisht 29 dhe 30 Qershor 2020. Gjatë vizitave ekspertëve iu vendos në dispozicion një sallë mbledhjesh për të kryer të gjitha takimet sipas axhendës. Stafit akademik dhe administrativ i Universitetit Epoka u angazhua për t’iu përgjigjur kërkesave të grupit të jashtëm. Disa dokumenta shtesë të kërkuara u depozituan nga IAL në datën 03.07.2020.

Pas rishikimit të dokumentacionit të institucionit dhe intervistave me pyetje të përcaktuara të ekspertëve dhe specialistes së ASCAL, GVJ paraqet si më poshtë vlerësimin e tij sipas standarteve dhe për çdo kriter që i referohet standartit për programin e studimit Bachelor në “Financë-Bankë” (shqip).

Në fund paraqiten pikat e dobëta, pikat e forta dhe rekomandimet për programin e studimit. Ky raport është përpiluar në bashkëpunim midis dy ekspertëve të jashtëm dhe paraqet mendimet e tyre të integruara.

Universiteti Epoka është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 16.09.2020, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 94/31 Prot, datë 16.09.2020. Universiteti Epoka përcjell nëpërmjet sistemit AMS më datë 25 shtator, komente në lidhje me draft raportin.

GVJ pasi u njoh me komentet e Institucionit mbi draft raportin, sqaron si vijon:

1. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi I3 Kriteri 3;**

GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon, pasi kriteri kërkon së pari që rezultatet e të nxënit, aftësitë, shkathësitë, etj të lidhen me nevojat e tregut të punës, nevoja që nuk janë studiuar në mënyrë të përshtatshme sikurse nxirret në pah në raport. GVJ në konstatimin e bërë është bazuar në RVB e përgatitur nga vetë GVB, ku nuk gjendet asnjë referencë për suplementin e diplomës.

2. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi I.5 Kriteri 3, dhe Standardi I.5 Kriteri 5;**
GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon, sepse Institucioni nuk ofron në komentet e tij evidencë të mëtjshme që justifikon analizën e munguar të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit. Së dyti, opinionin e anëtarëve të GVJ për mungesën e trajnimeve u mbështet jo vetëm në dokumentat e paplota të ofruara nga Institucioni por edhe në vizitën në laboratorët e informatikës, dhe për më tepër, në intervistat e zhvilluara me studentët.
3. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi II.1 Kriteri 5;**
GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon sepse vetë Institucioni e pranon mungesën e shpjegimeve të detajuara për çdo temë të lëndëve në syllabuse dhe deklaron se kjo do të përmbushet së shpejti duke filluar qysh nga viti akademik 2020-2021. Edhe VKM Nr. 879, dt.18.12.2019, i cituar nga Institucioni në koment, në shtojcën numër 3 të tij, përforcon dhe nuk hedh poshtë, shoqërimin e temave me një paragraf shpjegues.
4. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi II.3 Kriteri 1;**
GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon, sepse asnjë nga referencat e dhëna nga Institucioni në RVB dhe DVV nuk ndihmon GVJ të formojë një opinion për këtë kriter, dhe për më tepër gjykon që komentet e dhëna nga RVB pas opinionit të GVJ nuk sqarojnë aspak situatën kaotike të mungesës / konfuzionit të informacionit.
5. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi II.3 Kriteri 7;**
GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon, sepse vetë komenti nga RVB nënkupton disponibilitet të Institucionit për të reflektuar në lidhje me këtë sugjerim të GVJ-së. Gjithashtu, llogjika e përmbajtjes së programeve të studimit në nivel bachelor dhe synimi i këtyre programeve në këtë nivel nuk i bën të dosmosdoshme kaq shumë lëndë të Metodave të Kërkimit sac ofrohen nga ky program studimi.
6. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi II.4 Kriteri 5;**
GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon, sepse rekomandimi numër 2 i Bordit të Akreditimit është që praktika profesionale të jetë lëndë e detyrueshme në kurrikulën e këtij programi studimi dhe jo lëndë me zgjedhje, dhe përfshirja si lëndë e detyrueshme duhet të kishte filluar më herët në kohë (qysh pas akreditimit të mëparshëm, pra vitit 2017 – 2018 dhe jo në vitin akademik 2020-2021. Akreditimi aktual që po kryhet tashmë në vitin 2020, e gjen praktikën profesionale, ende një lëndë me zgjedhje aktualisht, për secilin prej viteve akademike të kaluara që GVJ mori në shqyrtim. Se çfarë do të ndodhë në të ardhmen do të gjykohet nga akreditimi i radhës dhe nuk duhet përdorur si argument që ky rekomandim është përmbushur plotësisht. Gjykojmë që Institucioni nuk ka përse të vazhdojë të këmbëngulë që rekomandimi është përmbushur plotësisht.
7. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi II.4 Kriteri 7;**
GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon, sepse rekomandimi i dhënë nga GVJ synon përmirësimin e përmbajtjes lëndore të programit të studimit dhe besojmë fort se pavarësisht larmisë së lëndëve me zgjedhje, përfshirja në këtë gamë e lëndëve të profesionit (financë, kontabilitet, bankë), vetëm do të rrisë më tej cilësinë e programit.

8. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi II.4 Kriteri 9;**
GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon, sepse përpos konstatimeve në draft RVJ, edhe linku i dhënë nga ana e GVB në komentet pasuese në lidhje me analizën është bosh (nuk hapet), duke treguar mungesë vëmendjeje ndaj sugjerimeve të GVJ. Cfarë GVJ vëren është që edhe në komente janë ofruar argumente jorelevante nga ana e Institucionit.
9. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi II.5 Kriteri 1;**
GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon, sepse komentet e GVB dhe diploma e dërguar janë për një PAK të angazhuar në këtë program dhe jo të PAE për të cilën GVJ i referohet gjatë raportit bazuar në konstatimet e bëra gjatë vizitës në IAL. Për arsye konfidencialiteti nuk citojmë emra në RVJ.
10. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi II.5 Kriteri 2;**
GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon, sepse komenti është dhënë pikërisht kështu nga stafi i Institucionit gjatë intervistave të kryera. Nga ana tjetër, thelbi i konstatimit të bërë nga GVJ në këtë kriter, është fakti që ngarkesa e lartë e stafit PAE, si në numër orësh, si në numër lëndësh përtej një limiti të arsyeshëm, pavarësisht se nuk shkel një ligj, rregullore apo kriter specifik, është e pamohueshme se prirjet të çënojnë cilësinë në mësimdhënie, kjo është arsyja përse GVJ e ka ngritur si një çështje që duhet të shihet me prioritet nga ana e Institucionit.
11. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi III.1 Kriteri 4;**
GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon, sepse pavarësisht konstatimit se vlerësimi i programit të studimit nuk është kryer sic kërkohet dhe mbi të gjitha nuk është paraqitur në mënyrë të përshtatshme, GVJ e vlerëson këtë Standard si të përmbushur plotësisht nga ana e Institucionit.
12. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi III.2 Kriteri 6;**
GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon, sepse GVJ e vlerëson këtë Standard si të përmbushur plotësisht nga ana e Institucionit. Përtej kësaj, GVJ shton një sugjerim për Institucionin, që emërtimi si leksione apo seminare në planin mësimor të programit të studimit, duhet të respektojë traditën emërtuese të orëve mësimore në realitetin shqiptar, si edhe definicionet në kornizën ligjore shqiptare.
13. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi III.6 Kriteri 3;**
GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon, pasi pavarësisht argumentimit të gjatë dhe të detajuar nga ana e GVB në lidhje me konceptin e "titullarit të lëndës", konstatimi i GVJ në këtë kriter, nuk lidhet me konceptin e titullarit të lëndës por specifikisht me komisionet e provimeve që janë me një anëtar dhe jo me dy sic i kërkon kriteri. Sigurisht që i vetmi anëtar i komisionit të provimit, që është lektor lënde, automatikisht konsiderohet titullar i lëndës, pavarësisht se Institucioni ende nuk ka ndërmarrë hapa për caktimin e këtyre pozicioneve. Në përfundim, pavarësisht sa më lart, GVJ e vlerëson këtë Standard gjithsesi si të përmbushur plotësisht nga ana e Institucionit.
14. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi III.7 Kriteri 2;**
GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon, sepse rekomandimet e dhëna nga ana e GVJ në lidhje me pasurimin e përmbajtjes së programit të studimit, janë thelbësore për rritjen e cilësisë së pritshme në të ardhmen për këtë program. Vlerësojmë faktin që

Institucioni, sic duket edhe nga komenti i GVB, po planifikon të reflektojë këto rekomandime në të ardhmen, të paktën përsa i përket lëndëve me bazë financën dhe aftësimin kompjuterik financiar dhe kontabël.

15. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi III.7 Kriteri 2, pjesa II;**
GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon, pasi çfarë është shprehur në RVJ bazohet në intervistat e kryera me studentë të programit. Përgjigjet e dhëna prej tyre, sigurisht që mund të jenë subjektive dhe jo përgjithësuese për këtë program studimi, por GVJ duke anuar në anën e të qenit „prudent“ nuk e ndryshon vlerësimin për këtë kriter.
16. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi IV.2 Kriteri 4;**
GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon, pasi pavarisht se kuadri ligjor dhe rregullator nuk ka vendosë një kufi të sipërm për orët mësimore për PAE-të në një IAL jopublike, mbingarkesa me mbi 500 orë mësimore në auditor (në disa raste edhe mbi 600 orë mësimore dhe kryesisht tek PAE pa grada shkencore apo tituj) ndikon negativisht në cilësinë e punës së tyre në auditor dhe mundësinë për tu angazhuar cilësisht në kërkime dhe projekte shkencore.
17. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi IV.4 Kriteri 2;**
GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon, pasi pavarisht evidencës shtesë të sjellë nga IAL pas dërgimit të draft RVJ-së, përsëri ajo përbën një faturë me të dhëna sintetike e cila nuk evidenton nëse fondi i shpenzuar ka shkuar për blerjen e literaturës në shqip apo gjuhën angleze. Ndërkohë që është vlerësuar pozitivisht numri i konsiderueshëm i literaturës në gjuhë të huaj që ka UE, por në këtë kriter kërkohen evidenca të sakta vetëm për blerjen e literaturës në gjuhën shqip, të evidentuar si çështje edhe tek literatura e referuar në syllabulls të lëndëve të këtij programi studimi. Gjithësesi, pavarisht konstatimeve dhe rekomandimeve të dhënë për këtë standard me qëllim që IAL ti ketë në konsideratë për ndjekje, vlerësimi është dhënë se përmbushet pasi janë rekomandime të arritshme për një IAL e cila ka investuar në këtë drejtim referuar plotshmërisë së titujve të librave në gjuhë të huaj të verifikuar gjatë vizitës në bibliotekën e UE si edhe elektronikisht në bazën e të dhënave.
18. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi IV.4 Kriteri 5;**
GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon, pasi RVB kishte mungesë të informacionit narrativ për përgjigje të dokumentuar lidhur me këtë kriter, gjithashtu nuk pati plotësim gjatë dhe pas vizitës së kryer në IAL.
19. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi IV.4 Kriteri 6;**
GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon, pasi GVJ bazuar në praktikat më të mira për Kampuset Universitare vijon ta lërë këtë qëndrim të shprehur në RVJ.
20. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi IV.5 Kriteri 1 dhe 2;**
GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon, pasi komentet nuk japin zgjidhje për çështjet e ngritura në RVJ lidhur me certifikimin e sigurisë së EIS.
21. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi IV.5 Kriteri 6;**

GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon, pasi edhe komentet e dhëna vijojnë të mos sjellin ndryshimin e kërkuar dhe të përshkruar për këtë kriter në RVJ.

22. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi IV.6 Kriteri 1 dhe 2;**

GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon, pasi fakti qëndron se IAL nuk ka raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planit për mbështetjen financiare të këtij programi ashtu siç e kërkon edhe ky standard.

23. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi IV.6 Kriteri 5;**

GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon, pasi në RVJ është shkruar ajo çfarë konstatohet nga raporti i të dhënave të gjetura në dokumentat e publikuara nga vet IAL.

24. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi V.3;**

GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon, pasi komentet nuk sjellin asgjë shtesë lidhur me pozicionet e punës të pozuara në RVB si edhe në ato çfarë vetë studentët e kontaktuar të këtij program gjatë vizitës në IAL dinin se do të mund të punësoheshin pas diplomimit. Ata e kishin të qartë këtë përmes kontakteve në tregun e punës dhe rrjetit ALUMNI.

25. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi V.4,**

GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon, pasi komentet risjellin të njëjtat qëndrime lidhur me EIS të cilat gjenden edhe në komentet për standardin IV.5, kriteri 1 dhe 2, të përmendura në pikën 20 më sipër.

26. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi V.5 kriteri 1 dhe 2;**

GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon, pasi RVB dhe komentet e dhëna nuk kanë dhënë ndonjë fakt të dokumentuar se ka përfaqësim të studentëve në Bordin e Administrimit të IALS-së, gjë e cila kërkohet edhe në kriterin 1 dhe 2 të këtij stadardi “Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse”, si edhe “përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme”.

27. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi V.5 kriteri 3, 4 dhe 5;**

GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon, pasi janë të njëjtat komente si edhe ato për komentin 23 më sipër.

28. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi V.6;**

GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon, pasi komentet e sjella janë të trajtuara në RVJ dhe është e rëndësishme përgatitja e një raporti për studentët e këtij programi dhe jo raporte sintetike për gjithë programet në fushën e ekonomisë si edhe çfarë masash janë marrë nga organet drejtuese të IAL-së pas raportimeve të bëra nga ZPKSD.

29. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi VI.1,**

GVJ konkludon që Raporti për pikën e parë nuk ndryshon, pasi konstatimi i dhënë në RVJ është në frymën e sigurimit të plotësimit të kriterit i cili kërkon që IAL harton politika,

procedura dhe struktura “që synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjste përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.

30. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në Standardi VI.1;

GVJ konkludon që Raporti për pikën e dytë nuk ndryshon, pasi justifikimi i dhënë për shkak të COVID nuk qëndron pasi mandatet e 10 anëtarëve dhe kryetarit të Komisionit të përhershëm për Sigurimin e Cilësisë kanë përfunduar që në vitin 2019 dhe kujdesi i Senatit Akademik për zgjedhjen e tyre duhet të ishte kujdesur ta siguronte vijimësinë para se të vinte përfundimi i mandateve dhe jo të priste muajin Mars 2020.

31. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në Standardi VI.2;

GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon, pasi komentet e sjella nuk kanë evidenca të cilat mungonin edhe në RVB për praktika të aplikuara nga UE për ndjekjen e procedurave standarde dhe të dokumentuara për kryerjen e ndryshimeve në planet mësimore bazuar në raportet dhe analizat e vlerësimit të cilësisë së kryer nga kjo IAL.

32. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në Standardi VI.3;

GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon, pasi përsëri GVB ripërsërit ato çfarë janë thënë në RVB por përsëri pa evidenca ndryshe nga çfarë kanë thënë në RVB. Ndërsa për raportin e vlerësimit të Evalag dhe ACCA për këtë program studimi, RVJ ka shprehur mungesën e publikimit të këtyre raporteve dhe jo të raporteve të tjera të vlerësimit të jashtëm të cilat i publikon edhe vet ASCAL.

33. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në Standardi VI.4;

GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon, pasi komentet e dhëna ashtu siç është shprehur edhe në RVJ për RVB-në konstaton se nuk janë dhënë referenca dhe evidence konkrete të aplikuara në përgjigje për atë çfarë kërkojnë kriteret me qëllim sigurimin e cilësisë për të përfshirë disa struktura, palë dhe individë të cilët duhet të kenë detyra dhe përgjegjësi të ndara qartë, infrastrukturën e duhur, mandatin e qartë, si edhe pavarsinë për të plotësuar detyrat e tyre.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në:


“Financë Bankë (shqip)”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Universiteti “EPOKA,” është një Institucion i Arsimit të Lartë i cili si misionin e përgjithshëm të tij (<i>referuar Statuti i Institucionit, Dhjetor, 2016, neni 3</i>) deklaron se ka ofrimin e shërbimeve arsimore dhe kërkimore inovative dhe ndikuese në shërbim të vlerave themelore njerëzore përmes prodhimit, zhvillimit dhe përcimit të njohurive si edhe dhënien e kontributit për përmirësimin e cilësisë së jetës së shoqërisë në përputhje me nevojat kombëtare dhe rajonale. Aktualisht Institucioni ofron programe studimi në tre fusha – ekonomike, inxhinierike dhe sociale – dhe këto programe studimi pritet të formojnë studentë të cilët të kontribuojnë për avancimin e njohurive dhe aplikimeve praktike të këtyre disiplinave në vendin tonë.
Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Statuti i Institucionit (<i>neni 3</i>) deklaron se qëllimi i përgjithshëm i Universitetit Epoka është përgatitja e individëve të kualifikuar, produktivë, të aftë, me etikë profesionale dhe të ndjeshëm kundrejt shoqërisë. Ndër objektivat e Institucionit (<i>Statuti, neni 3</i>) që burojnë nga ky qëllim i përgjithshëm listohen, ndër të tjera edhe: a) kontributi në zhvillimin ekonomik të vendit dhe b) kontributi për rritjen e standardeve demokratike dhe mirëqënien e shoqërisë dhe përgatitja e të rinjve për të kontribuar aktivisht në shoqëri. GVJ gjykon se bazuar në misionin, qëllimin dhe objektivat e tij, Institucioni ka në fokus ruajtjen e vlerave akademike (kërkimi, kualifikimi, etika) dhe ato shoqërore (kontributi dhe pjesëmarrja aktive në shoqëri).
Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	GVJ vërejt se programi i studimit Bachelor në Financë – Bankë (shqip) është i hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e Institucionit sic deklarohen në Statutin e tij (<i>neni 3</i>). Strategjia e Zhvillimit të Institucionit (2018-2022) përforcon qëllimin e tij për të ofruar shërbime cilësore në fushën e veprimtarisë ekonomike (ku fusha Financë Banka

	<p>është pjesë) dhe për të qenë lider në sektorin e ofrimit të shërbimeve arsimore në vendin tonë.</p> <p>(Strategjia e Zhvillimit të Institucionit 2018-2022, pika 2, faqja 6).</p>			
<p>Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>Nga shqyrtimi i DVV, konstatohet se Programi i studimit Bachelor në Financë-Bankë (shqip) i Universitetit Epoka fokusohet në një sektor me rëndësi të ekonomisë shqiptare, pikërisht sektorin financiar dhe bankar. Qëllimi i programit të studimit për aftësimin e të rinjve në këtë sektor, dhënien e dijeve dhe njohurive për institucione financiare dhe bankare, është në përputhje me zhvillimet ekonomike kombëtare por edhe rajonale.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<p>Standardi I.2</p> <p>Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>Ndër dokumentet më të rëndësishme, pjesë e DVV të dorëzuar nga Institucioni, në të cilat përcaktohet strategjia e zhvillimit të institucionit dhe programeve të tij janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Strategjia e Zhvillimit të Institucionit 2018-2022; 2. Plani Strategjik për Departamentin e Financë-Bankës 2018-2022; <p>GVJ pasi shqyrtoi këto dy dokumenta konstaton se programi i studimit Bachelor në Financë-Bankë (shqip) paraqitet në përputhje me qëllimet dhe objektivat e institucionit, të përcaktuara në “Strategjinë e Zhvillimit” të tij.</p>
<p>Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Universiteti Epoka, sic konstaton GVJ mbështetur në shqyrtimin e Statutit të Institucionit, ka identifikuar në mënyrë të qartë dhe transparente drejtimit prioritar akademike të tij, (neni 3, Statuti i Institucionit) të cilat janë: “inxhinieri kompjuterike, inxhinieri civile, arkitekturë, ekonomiks, <u>bankë dhe financë</u>, administrim biznesi, ligje, shkenca politike dhe marrëdhënie ndërkombëtare.”</p>



	GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në Financë Bankë (shqip) është i orientuar në përputhje me njërën nga fushat akademike të identifikuar në pikën më lart.			
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.	Bazuar në shqyrtimin e Rregullores së Programit të Studimit, Planit Mesimor dhe dokumenta të tjerë në DVV, GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në “Financë-Bankë (shqip)” i ofruar nga Universiteti Epoka, është një program studimi i Ciklit të Parë me 180 kredite, me formë studimi me kohë të plotë, i ofruar dhe realizuar në <u>gjuhën shqipe</u> , i organizuar me një kohëzgjatje normale 3 vite (6 semestra ku cdo vit ka dy semestra). Në përfundim të studimeve lëshohet diplomë universitare Bachelor në “Financë-Bankë”. Nga shqyrtimi i Planit Mësimor të Programit të Studimit, GVJ arrin në përfundimin se programi është strukturuar dhe organizuar në lëndë të vlerësuara në kredite, sipas nivelit të kualifikimit të kërkuar në përputhje me Ligjin për Arsimit të Lartë dhe Kërkimin Shkencor, udhëzimet e Ministrit të Arsimit, Sportit e Rinisë (MASR) dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Përmbajtja e programit të studimit është gjithashtu në përputhje me drejtimin akademik të Institucionit sic shprehet në Statutin e tij dhe me planet strategjike sic paraqiten në “Strategjinë e Zhvillimit të Institucionit 2018-2022.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3	
Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga ana e Institucionit në faqen e ASCAL, GVJ konstaton se në Statutin e Institucionit dhe në Planin Strategjik të Departamentit të Financë – Bankës paraqiten objektiva të përgjithshme të Institucionit dhe programeve të studimit që ai ofron (studentëve u sigurohen aftësi të specializuara për zgjidhjen e problemeve të nevojshme për kërkime dhe inovacion në mënyrë që të zhvillojnë njohuri dhe procedura të reja, si dhe të integrojnë njohuritë nga fusha të ndryshme). Përsa i përket objektivave të mësuarit të këtij



	<p>programi studimi, ato janë të përfshira në syllabuset e lëndëve të programit të studimit.</p> <p><i>GVJ gjykon se do të ishte i nevojshëm dhe i dobishëm hartimi i një dokumentacioni të përmbledhur në të cilin të jenë të përmbledhura misioni, qëllimi dhe objektivat për formimin e studentëve, si edhe dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që ata pritet të fitojnë në përfundim të programit të studimit Bachelor në Financë Bankë (shqip). Këto elemente mundet fare mirë të jenë pjesë e Guidës së Studentit.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar, GVJ konstaton se Institucioni deklaron në RVB kryerjen e analizës së tregut të punës përpara hapjes së programit të studimit. Në RVB gjithashtu deklarohet se ky program hapet në gjuhën shqipe për ata studentë që kanë vështirësi me gjuhën angleze. <i>Megjithatë, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit pjesë e DVV, GVJ nuk gjen dokumenta për studimin e tregut të kryera nga Institucioni.</i> Cfarë është dorëzuar janë studime dhe kërkime nga palë të treta si: “Trendet e Punësimit Rinor në Shqipëri” (2015) dhe “Dinamikat e Tregut të Punës“(2001-2011), “Shqipëria – një vlerësim i tregut të punës” (2006), të cilat edhe janë listuar në një dokument më vete. Por këto studime nuk janë kryer nga Institucioni dhe rrjedhimisht nuk përmbajnë komunikime me punëdhënësit potencialë, mundësi të punësimit të studentëve dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p> <p><i>Për më tepër, nga ana e GVJ studimet vlerësohen të vjetra në kohë. Në lidhje me informacionin mbi punësimin real të studentëve të diplomuar, informacioni i ofruar nga Institucioni është një tabelë për vitin 2018 (Apendiks 29 në DVV), pa shpjegime dhe pa interpretime; si edhe studimi i tregut pas punësimit të studentëve, dhe apendiks 17 dhe 17.1 në DVV që ofrojnë analizë modeste të punësimit pas diplomimit, por përsëri në përgjithësi për Institucionin dhe jo në mënyrë të vecantë për këtë program studimi.</i></p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfitim të dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe</p>	<p>Qëllimi kryesor i programit të studimit Bachelor në Financë-Bankë (shqip) sipas RVB të plotësuar nga Institucioni është: “të përgatisë studentët me njohuri të thella përsa u përket koncepteve dhe parimeve të bankës dhe financave, duke ndërtuar themele të sigurta të teorisë dhe praktikës”. Rezultatet e pritshme të të nxënit, janë të përfshira në mënyrë të shkëputur në programet lëndore të</p>

lehtësojnë punësimin e studentëve.	vecanta, dhe pavarësisht kësaj, GVJ ka marrë kohë dhe i ka shqyrtuar, <i>por, fakti që mungon një studim tregu i kohëve të fundit me të cilin të përqasen përputhshmëria ose jo e qëllimit të programit dhe rezultateve të të nxënit, nuk e lejon GVJ të shprehet në favor të përmbushjes së këtij kriteri.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.4

Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.	<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar, vërejmë se në Universitetin Epoka, ofrohen programe studimi në fushën e Financë – Bankës në të tre ciklet e studimit, pra Bachelor, Master (Master Profesional dhe Master i Shkencave), dhe PhD. Gjuha e mësimin në të gjitha këto programe studimi është anglisht, përveç programit të studimit në fjalë, Bachelor në Financë–Bankë (shqip) i cili ofrohet në shqip për të tërhequr edhe atë segment të studentëve që nuk kanë njohuri të mjaftueshme në gjuhën angleze (sipas deklarimeve në RVB). GVJ konstaton se Institucioni disponon kapacitete në burime njerëzore të mjaftueshme për të garantuar realizimin e objektivave të këtij programi studimi dhe ka përvojë disavjecare në fushën e ofrimit të studimeve në disiplinën Financë – Bankë.</p> <p>Edhe Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative që ofron këtë program studimi, ka një eksperiencë 12 vjecare, sipas VKM Nr.281, datë 12.03.2008. Sipas evidencës (<i>RVBP_BA_BAF_Tabelat_shqip.pdf, tabela nr.1</i>), konstatohet se Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative për vitin akademik 2019-2020 ka gjithsej 42 pedagogë, nga të cilët 23 janë pedagogë efektiv (PAE) nga ku: 3 kanë titullin “Profesorë”, 4 kanë titullin “Profesorë të Asociuar”, 10 kanë gradën Dr./PhD, dhe 6 Asistent Lektorë me Msc; dhe 19 pedagogë me kontratë (PAK) nga ku 1 ka titullin “Profesor”, 4 kanë titullin “Profesorë të Asociuar”, 8 kanë gradën Dr./PhD. dhe 6 Asistent Lektorë me Msc.</p>

<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Njësia kryesore, përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, Bachelor në Financë Bankë (shqip) është Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative, dhe GVJ vëren se fusha e studimit e programit Bachelor në Financë – Bankë (shqip) është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë kryesore e cila është përgjegjëse për programin e studimit.</p>			
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Sipas Organogramës së Institucionit, (pjesë e dokumentacionit në DVV), Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative, i Universitetit Epoka i cili është njësia kryesore përgjegjëse për ofrimin e Programit të Studimit Bachelor në Financë – Bankë (shqip), përbëhet nga tre departmente:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Financë-Bankës; 2. Departamenti i Administrim Biznesit; 3. Departamenti i Ekonomiksit; <p>Departamenti i Financë-Bankës është njësia bazë që ofron programin e studimit Bachelor në Financë-Bankë (shqip) dhe GVJ konstaton se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit korrespondojnë me ato të njësisë bazë që e ofron këtë program.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi I.5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes</p>	<p>Nga analiza e Statutit të Institucionit (Neni 23), GVJ konstaton se Institucioni ka parashikuar mënyrën e funksionimit, ndarjen e detyrave dhe bashkëpunimin mes njësive përbërëse organike të tij. Cdo njësi ka detyra dhe objektiva ku njësitë bazë organizojnë veprimtari mësimore dhe kërkimore dhe njësitë kryesore koordinojnë aktivitetet e njësive bazë që ata</p>

<p>njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiave respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>përfaqësojnë. Njësitë administrative të përgjithshme të Institucionit mbështesin aktivitete të ndryshme të përgjithshme si infrastruktura, shërbimet e TIK, shërbimet e garantimit të cilësisë, menaxhimi i projekteve, etj. Përsa i përket analizës së punës së njësive institucionale, GVJ u ndal në dokumentin (<i>Department Assesment Database apendiks 37 në DVV</i>), i cili sipas titullit të tij duhej të nënkuptonte analizën e punës së departamentit, por që ishte një dokument i pamundur për t'u lexuar apo shqyrtuar për shkak të cilësisë së dobët të sintetizimit të tij. Megjithatë, departamenti Financë Bankë përgatit dhe publikon Raportin Vjetor ku përfshihet edhe analiza e punës së bërë prej kësaj njësie.</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar dhe sipas konfirmimeve të kryera pas vizitës në Institucion, GVJ konstaton se institucioni ka nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe si edhe me partnerë brenda dhe jashtë vendit. Një listë me universitetet bashkëpunuese është dhënë në (<i>apendiksin nr.32 në DVV, "Marrëveshjet e bashkëpunimit"</i>). Në tabelat e RVB jepet gjithashtu listë e plotë e marrëveshjeve të bashkëpunimit në nivel institucional dhe pasi u kërkuan nga GVJ pas vizitës në Institucion, u ofrua edhe lista e marrëdhënies të bashkëpunimit vetëm në favor të programit të studimit Bachelor në Financë Bankë (shqip).</p>
<p>Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Në RVB e përgatitur nga ana e Institucionit deklarohet se në kuadër të analizës së progresit të programit, përgatitet një Raport Vjetor nga Departamenti i Financë – Bankë, në të cilin analizohen arritjet, dhe përcaktohen objektivat, por në këtë Raport Vjetor, GVJ nuk gjeti analizë të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit. Gjithashtu sipas RVB, departamenti ka emëruar një anëtar përgjegjës për gjetjen dhe rritjen e numrit të marrëveshjeve përmes Erasmus + si dhe memorandumet e mirëkuptimeve me universitete të tjera jashtë vendit, por nuk u gjet informacion nga ana e GVJ në lidhje me këtë anëtar përgjegjës.</p> <p><i>GVJ konstaton se në DVV gjendet një dokument i titulluar "Raporti mbi Përfitimet nga bashkëpunimet" në të cilin jepet një përshkrim i shkurtër dhe modest të cilën GVJ e konsideron të pamjaftueshme (apendiksi 35 në sistemin e Ascal) pasi nuk është një analizë e mirëfilltë dhe madje ka dhe disa elemente të paplotësuara fare (seksioni i Financa 5 dhe programit Alpha).</i></p>

Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.	GVJ konstaton se Institucioni Epoka ka listuar një gamë të gjerë biznesesh dhe punëdhënësish potencialë pranë të cilëve mund të kryejnë praktikën studentët e Institucionit në tërësi. (<i>apendiksi 32 në DVV</i>). Në këtë listë gjenden edhe disa banka dhe institucione financiare si edhe biznese të ndryshme që operojnë në vendin tonë dhe të cilat mund të ofrojnë vende praktike në përputhje me specifikën e programit të studimit bachelor në Financë-Bankë (shqip).			
Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Në RVB raportohet se Institucioni organizon çdo vit trajnime profesionale, duke ftuar ekspertë nga Shqipëria dhe jashtë saj, përfshi këtu edhe trajnime përgatitore për përdorimin e programeve Financa-5 dhe Alpha. Megjithatë, <i>gjatë vizitës në Institucion, stafi konfirmoi se këto trajnime nuk kryhen për studentët e diplomuar në trajtën e trajnimeve profesionale të mëtejshme (por për studentët aktualisht në proces mësimor), pra ky kriter nuk përmbushet.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe	Mbështetur në tërësinë e dokumentacionit të dorëzuar GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në Financë Bankë (shqip) i ofruar në Universitetin Epoka, është i organizuar në lëndë të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi (Ligji për Arsimin e Latë 80/2015), dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi është me kohë të plotë dhe mësimdhënia është në gjuhën shqipe, me një kohëzgjatje 3 vjet

<p>Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>dhe 6 semestra në përfundim të të cilit do të lëshohet diplomë universitare “Bachelor”. Nga shqyrtimi i planit mësimor të Programit të Studimit, GVJ konstaton se disiplinat mësimore dhe veprimtaritë e tjera formuese që ofrohen në programin e studimit Bachelor në Financë Bankë (shqip) janë të organizuara në 5 kategori, nga A në E, në përputhje me VKM nr. 41. Disiplinat mësimore të ofruara në kategoritë A, B, C, D dhe E janë të detyrueshme dhe me zgjedhje dhe vlerësohen me kredite. (Sipas VKM nr. 41, datë 24.01.2018, e ndryshuar), në kategorinë A bëjnë pjesë disiplina të formimit të përgjithshëm për përgatitje metodologjike dhe kulturë të përgjithshme; në kategorinë B, që janë lëndët bazë, përfshihen disiplina të formimit karakterizues të programit për përgatitje shkencore; në kategorinë C përfshihen lëndë ndërdisiplinore, profile dhe grup-lëndësh me zgjedhje; në kategorinë D përfshihen lëndët plotësuese si dhe praktika profesionale. Ndërsa në kategorinë E janë detyrimet përmbyllëse.)</p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>GVJ konstaton se gama e lëndëve të detyrueshme dhe atyre me zgjedhje të përfshira në programin e studimit Bachelor në Financë Bankë (shqip) ofron një mbulim të mjaftueshëm të disiplinave specifike në fushat e Financës dhe Bankës dhe ofron larmi të përfitimit të njohurive përkatëse në këto fusha ndër të cilat mund të vecojmë formimin e aftësive profesionale në specialitetin e financës dhe bankës duke përfshirë teknikat e mbajtjes së kontabilitetit dhe raportimit financiar të njësive ekonomike, njohuri bazë të sistemit financiar dhe ndër lidhjen e aktorëve të sistemit financiar dhe vecanti të sistemit bankar në vendin tonë.</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuar në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Në RVB specifikohet se Programi i studimit Bachelor në Financë-Bankë (shqip) i përket Nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), dhe synon të mundësojë njohuritë themelore për metodat dhe parimet, si dhe aftësitë specifike në një larmi të gjerë profesionale dhe specialitetesh. Nga shqyrtimi i Planit Mësimor të Programit të Studimit dhe më tej të Syllabuseve të Lëndëve, GVJ konstaton se në tërësi ky program jep njohuri të kompletuara teorike dhe akademike në fushat e studimit Financë Bankë dhe i aftëson studentët për punësim të mëtejshëm.</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme</p>	<p>Sipas Planit Mësimor të programit të studimit Bachelor në Financë Bankë (shqip), GVJ konstaton se në përgjithësi programi i studimit ofron një larmi disiplinash të detyrueshme dhe me zgjedhje duke synuar aftësimin e studentëve në kompetenca të avancuara. Mbështetur në analizën të syllabuseve të lëndëve të programit, dhe sidomos në kontaktet</p>

për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	me studentët e programit, GVJ formoi opinionin se studentët nxiten të fitojnë kryesisht aftësi dhe kompetenca për problem zgjidhje jo konvencionale dhe të sofistikuar dhe ndjeheshin të gatshëm dhe të aftë të përballeshin me sfidat e tregut të punës.			
Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.	Programi i studimit Bachelor në Financë-Bankë (shqip), i ofruar nga Universiteti Epoka, është strukturuar në përputhje me Ligjin 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimit e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë". Elementët e programit të studimit Bachelor në Financë-Bankë (shqip) janë në përputhje kryesisht me Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM), nr.41, datë 24.01.2018, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë". <i>Syllabuseve u mungon detajimi i çështjeve në nëncështje dhe shpjegimi (rreth një paragraf) i çdo teme të leksionit sipas javëve, shoqëruar me literaturën përkatëse (të detajuar me faqe, sipas kërkesave të shtojcës nr.2 të kësaj VKM). Kjo mangësi u konfirmua edhe gjatë vizitës në Institucion si një çështje që pritet të përmirësohet me tej në vijim nga ana e Institucionit.</i>			
Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Sic konfirmohet nga shqyrtimi i Planit Mësimor të programit të studimit (tabela 9, shtojca RVB), konfirmohet se programi i studimit ka të grupuara lëndët sipas kategorive të përcaktuara në VKM nr.41 si edhe jep informacion për ngarkesën përkatëse në kredite duke garantuar përmbushjen e këtij kriteri.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore	Universiteti Epoka është akredituar për herë të parë si institucion sipas Urdhërit Nr. 260, datë 07.06.2011, të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Shqipërisë dhe ka marrë akreditimin institucional periodik në bazë të

<p>për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Vendimit Nr. 92, datë 20.10.2017, të Bordit të Akreditimit. Programi i studimit Bachelor në Financë-Bankë (shqip), i riformatuar në përputhje me sistemin e Bolonjës, i është nënshtruar akreditimit periodik të parë bazuar në Vendimin Nr. 76 të Bordit të Akreditimit, datë 21.09.2017, sipas të cilit kishte tre rekomandime. Analiza e GVJ mbi shkallën e përmbushjes së këtyre rekomandimeve është bërë në hyrje të këtij Raporti.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>Në RVB Institucioni raporton se njësia kryesore / bazë përgjegjëse për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për mbarëvajtjen dhe zhvillimin e programit dhe praktikave në përputhje me objektivat e tij, dhe orienton si referim Statutin e Institucionit (<i>neni 50</i>) dhe shtojcën 36 e cila përshkruan detyrat e Përgjegjësit të Departamentit për shkak se (sic edhe u verifikua gjatë vizitës në Institucion,) Universiteti Epoka, si pjesë e praktikave të veta, aplikonte njehsimin e rolit të përgjegjësit të departamentit me atë të koordinatorit të çdo programi studimi të ofruar nga ai departament specifik. Në këtë rast, rolin e koordinatorit të programit të studimit Bachelor në Financë Bankë (shqip) e luan përgjegjësi i departamentit të Financë – Bankës.</p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Sic specifikohet në nenin 23 të ligjit të IAL “Fakulteti organizohet në së paku tri njësi bazë, së paku dy prej të cilave janë departamente”, GVJ konfirmon nga organograma se Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative të Universitetit Epoka, e përmbush këtë kriter pasi ka në përbërjen e tij tre departamente (Departamenti i Administrim Biznesit, Departamenti i Financë – Bankës dhe Departamenti i Eknomiksit).</p> <p>Referuar dokumentacionit të dorëzuar (<i>tabela 1 në shtojcat e RVB</i>), në vitin e fundit akademik 2019-2020, Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative i Universitetit Epoka nga 42 staf gjithsej, ka 23 pedagogë me kohë të plotë (pra 55.5% të stafit total), dhe 19 pedagogë me kohë të pjesshme (44.5% të stafit total).</p> <p>Pjesë e stafit të brendshëm PAE janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 3 Prof.Dr; - 4 Prof.As.Dr; - 10 Dr; - 6 Msc

	<p><i>GVJ gjatë shqyrtimit të dokumentacionit pranë zyrës së BNJ konstatoi se një staf PAE i punësuar gjatë vitit akademik 2019-2020 kishte titullin Master Profesional dhe jo Msc.</i></p> <p>Në stafin e jashtëm PAK janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 1 Prof.Dr; - 4 Prof.As.Dr; - 8 Dr; - 6 Msc <p><i>Për vitet e tjera akademike, nuk jepen të dhëna në RVB në lidhje me numrin e stafit PAE dhe PAK per njesine kryesore.</i></p> <p>Ne lidhje me njesine baze, sipas evidencës (RVBP_BA BAF_Tabelat_shqip.pdf, tabelat nr.2.1, 2.2 dhe 2.3) rezulton se për vitin aktual 2019-2020, njesia baze, pra departamenti ka në përbërje gjithsej 18 personel akademik nga ku 8 personel akademik efektiv (PAE), nga ku 6 me grada/tituj, dhe 10 personel akademik me kontrate (PAK), nga ku 8 me grada/tituj.</p> <p>Në dy vitet e mëparshme akademike raportet PAE/PAK të departamentit përgjegjës për programin e studimit kanë qënë:</p> <p>Për vitin akademik 2017-2018, (7 / 13), nga këta me grada/tituj shkencore 4 / 9;</p> <p>Për vitin akademik 2018-2019, (8 / 12), nga këta me grada/tituj shkencore 6 / 10;</p>
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>	<p>Referuar shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar (tabelat në RVB dhe verifikim gjatë vizitës në Institucion), GVJ konstaton se Fakulteti i i Shkencave Ekonomike dhe Administrative i Universitetit Epoka, përmbush kriterin për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik. Kështu, referuar dokumentacionit të dorëzuar, në vitin e fundit akademik 2019-2020, Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative nga 42 staf gjithsej, ka 23 pedagogë me kohë të plotë dhe 19 pedagogë me kohë të pjesshme (raporti 55.5 % / 44.5 %). Pjesë e stafit të brendshëm PAE janë 3 me titullin Prof.Dr; 4 Prof.As.Dr; 10 Dr; dhe 6 MSc. Në stafin e jashtëm janë 1 Prof.Dr; 4 Prof.As.Dr, 8 Dr., dhe 6 MSc.</p>
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për</p>	<p>Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në Financë-Bankë (shqip), është Departamenti i Financë-Bankës. Referuar të dhënave të dorëzuara në RVB si edhe konfirmimit gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstaton se kjo njësi bazë</p>



<p>organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>përbush kërkesat ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të stafit.</p> <p>Gjatë vitit akademik 2019-2020 ky departament ka 8 pedagogë me kohë të plotë dhe 10 me kohë të pjesëshme. Në stafin me kohë të plotë janë 1 Prof.Dr; 1 Prof.As; 4 Dr. dhe 2 MSc, ndërsa në stafin e jashtëm janë 2 Prof.As; 6 Dr. dhe 2 MSc.</p> <p>Në vitin akademik 2018-2019, departamenti ka patur 8 pedagogë me kohë të plotë dhe 12 me kohë të pjesëshme. Në stafin me kohë të plotë janë 1 Prof.As; 5 Dr. dhe 2 MSc, ndërsa në stafin e jashtëm janë 1 Prof.Dr, 3 Prof.As; 6 Dr. dhe 2 MSc.</p> <p>Në vitin akademik 2017-2018, Departamenti ka patur 7 pedagogë me kohë të plotë dhe 13 me kohë të pjesëshme. Në stafin me kohë të plotë janë 1 Prof.As; 3 Dr. dhe 3 MSc, ndërsa në stafin e jashtëm janë 1 Prof.Dr; 2 Prof.As; 6 Dr. dhe 4 MSc. RVB e plotësuar nga Institucioni, në këtë seksion gjithashtu jep informacion jo relevant.</p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi II.3

Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.

<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Sipas RVB departamenti i Financë-Bankës disponon informacionin e nevojshëm për programin e studimit Bachelor në Financë-Bankë (shqip) dhe si referencë është cituar neni 12 i Statutit të Universitetit, por GVJ konstaton se neni 12 i Statutit trajton departamentin dhe jo programin e studimit. <i>Në të njëjtin kriter, RVB referon si dokument referencial Rregulloren bazë (themelore), por GVJ ndesh dy variante të rregullores bazë, një në anglisht sic referohet me link në RVB dhe një në faqen e Ascal, pjesë e DVV (shtojca 5), ku të dy dokumentat nuk përputhen me njëri tjetrin (nenet nuk janë të njëjtat në të dy rregulloret). Gjatë vizitës në Institucion ky fakt u vu në dukje për Grupin e Vlerësimit të Brendshëm por pa marrë një përgjigje të kënaqshme apo argumentuese prej tyre.</i></p>

<p>Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Financë-Bankë (shqip) është organizuar në lëndë dhe aktivitete formuese, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe për të argumentuar këtë fakt RVB referon shtojcën 7 në DVV e cila është në fakt rregullore e programeve të studimit të nivelit bachelor në Epoka, dhe jo specifikisht për këtë program studimi dhe aq më pak nuk përmban informacion për aktivitetet formuese, lëndët, etj.</p> <p><i>Përsëri, si GVJ gjykojmë se RVB nuk reflekton në mënyrë të qartë informacionet e nevojshme, por nga shqyrtimi i Planit Mësimor dhe i programeve lëndore konstatojmë se ky program studimi është i organizuar në lëndë, praktikë dhe aktivitete formuese.</i></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>GVJ konstaton se organizimi i veprimtarisë mësimore vjetore të programit të studimit Bachelor në Financë Bankë (shqip) në Universitetin Epoka shtrihet në tre vite akademike secili me nga dy semestra që kanë kohëzgjatje normale 14 javë. Programi i plotë shtrihet në 6 semestra, në të cilin trajtohen lëndët të cilat janë të vlerësuar me kredite sipas sistemit evropian, ECTS. Praktika mësimore është lëndë me zgjedhje e ofruar në semestrin e pestë, kurse mbrojtja e temës së diplomës ose dhënia e provimit përmbledhës bëhen në përfundim të semestrit të gjashtë.</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Nga shqyrtimi i Planit mësimor të programit të studimit Bachelor në Financë Bankë (shqip), (apendiksi nr.14 në DVV), GVJ konstatoi se ky dokument jep informacion në lidhje me ngarkesën mësimore, orët në auditor dhe jashtë auditorit. Përsa i përket elementeve të tjera: frekuentimi /ndjekja e programit dhe mënyra e vlerësimit të dijeve, vërejmë se ato janë të specifikuar në programet lëndore të secilës lëndë. Përsa i përket frekuentimit të studentëve ky Institucion ka vendosur limitin e detyrueshëm 60 %</p> <p><i>(Student Smart Guide, Shtojca 9.1 në DVV).</i></p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Përsa i përket pranimeve, transferimeve apo / dhe ekuivalentimeve të studimeve në Institucion, në RVB të përgatitur thuhet se Programi i studimit Bachelor në Financë-Bankë (shqip) u mundëson studentëve të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me kriteret e përgjithshme dhe specifike për pranimin, transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve të specifikuar në Nenin 32 dhe 33 për Rregulloren Themelore të Universitetit “EPOKA” dhe referon një link që të con në faqen e internetit të Universitetit si edhe shtojcën 5 në RVB. GVJ konstaton se këto tre burime</p>

	<p>nuk kanë asnjë përputhje me njëra tjetrën dhe nuk sigurojnë informacion relevant në lidhje me kriterin në fjalë. Megjithatë GVJ shqyrtoi të dhënat e dokumentacionit dhe konstatoi se si kusht pranimi në programin e studimit Bachelor në Financë Bankë (shqip) është diploma e shkollës së mesme me një mesatare të paktën 6.5 ose ekuivalente e saj.</p> <p>Në lidhje me transferimet dhe ekuivalentimet e studimeve, GVJ shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar (<i>Rregullorja Themelore, nenet 32 dhe 33</i>) konstatoi se ato nuk trajtonin transferimet apo pranimet, pra ka përsëri mospërputhje mes dokumentave referuese. Megjithatë, GVJ iu referua të dhënave të raportuara në tabelën 21 në shtojcat e RVB dhe konfirmuar edhe në vizitën në Institucion, për këtë program studimi, ka pasur 5 transferime në hyrje të gjitha nga brenda vendit, ndërkohë që ka pasur dy studentë të transferuar në dalje.</p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Në këtë kriter, RVB e përgatitur nga Institucioni të drejton tek shtojca 19, e cila mungon ndër dokumentet e dorëzuara në DVV, duke përsëritur të njëjtin fenomen të vërejtur të mungesës së dokumentave (kjo shtojcë u vendos në dispozicion më vonë pas kërkesës së bërë nga GVJ gjatë vizitës në Institucion). GVJ ka shqyrtuar edhe programet lëndore përkatëse të programit të studimit të cilat janë pjesë e dokumentacionit. Referuar këtyre të dhënave GVJ konstaton se syllabusi i cdo lënde përmban informacionet e nevojshme të detajuara, në lidhje me praktikat, seminarët (nëse ka) dhe orë laboratorit (nëse ka) në përputhje kjo me VKM nr.41 si edhe mënyrën e vlerësimit që ndjek çdo pedagog, e cila varion në një interval të lehtë nga një lëndë në tjetrën. Nota përfundimtare është rezultante e elementëve të vlerësimit: Provimet + detyra kursi/projekte individuale + pjesëmarrja aktive në procesin mësimor.</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Përgjegjësi i njësisë bazë, pra në këtë rast përgjegjësi i Departamentit të Financë-Bankës (<i>sipas nenit 54 i Statutit të Institucionit</i>) ka si pjesë e funksioneve të tij edhe kryerjen e hapave të nevojshëm për rishikimin dhe përmirësimin e programit të studimit. Sipas konfirmimeve në Institucion përpjekjet për përmirësimin e programit mund të vijnë edhe si iniciativë e pedagogë të programit, apo në reflektim të sugjerimeve për përmirësim nga agjensitë e akreditimit. Si procedurë, rishikimet e programit, ndërmerren në fund të një viti akademik për t'i paraprirë organizimit të punës për vitin në vijim dhe pasi miratohen nga përgjegjësi i departamentit i cili e përcjell në dekanat, finalizon nga Komisioni i</p>

	Rishikimit të Kurrikulave. Në Shtojcat e RVB (tabela 11) aksesohen ndryshimet që kanë ndodhur në përmbajtjen e programit të studimit gjatë tre viteve të fundit të, <i>cilat janë kryer përgjithësisht me një frymë të qartë përmirësimi dhe përditësimi me përjashtim të zëvendësimit të lëndës "Menaxhim dhe Organizim" me lëndën "Hyrje në Metoda Kërkimore", për të cilën GVJ është e opinionit se studentëve të nivelit bachelor në Financë Bankë (shqip), më shumë do t'u vlenite lënda e zëvendësuar sesa ajo zëvendësuese.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxëniet dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, Ligji nr. 80/2015 për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, neni 73 pika 1, kërkon që programet e ciklit të parë të studimit, të organizohen me jo më pak se 180 kredite europiane (ECTS) dhe kohëzgjatja normale e tyre është tri vite akademike. GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në Financë Bankë (shqip) në Universitetin Epoka është hartuar dhe organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, e shtrirë në tre vite akademike me nga 60 ECTS, pra 180 ECTS në total duke e përmbushur këtë kriter.
Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.	Duke gjykuar sipas dokumentacionit të dorëzuar nga Institucioni, GVJ mund të shprehet se programi i studimit Bachelor në Financë-Bankë (shqip), mundëson aftësimin e studentëve me kompetencat e përfshira në programet lëndore dhe pajisjen e tyre me aftësi për t'u punësuar në treg. Të pyetur për shkallën e njohurive dhe aftësive që kishin fituar gjatë studimeve, studentët e programit gjithashtu u shprehën konfidentë për punësim të mëtejshëm në pozicione fillestare pune në fushën e financës dhe bankës.
Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite	Nga shqyrtimi i Planit mësimor të programit të studimit që është pjesë e DVV, GVJ konstaton se shpërndarja e ngarkesës mësimore në tre vitet është përgjithësisht e balancuar dhe

<p>e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional.</p>	<p>mundëson kryesisht arritjen e objektivave të programit. (Objektivat formuese të këtij programi studimi specifik dhe rezultatet e pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional gjenden në programet e vecanat lëndore).</p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>GVJ shqyrtoi me prioritet syllabuset e lëndëve të ofruara në programin e studimit Bachelor në Financë Bankë (shqip) të Universitetit Epoka dhe konstaton se këto lëndë ofrojnë nivel kryesisht të kënaqshëm në përputhje me profilin e programit bachelor si edhe në ngjashmëri me programe ndërkombëtare të kësaj disipline.</p> <p>Gjatë vizitës në IAL, jo të gjithë studentët u shprehën se e kishin ndjekur kursin e trajnimit për programin Alpha apo Financa 5. <i>GVJ rekomandon në afatshkurtër brenda normës prej 20% të përmirësohet programi i studimit duke pasur parasysh disa elemente si shtimin e përgatitjes në fushën e njohurive të sistemit tatimor në Shqipëri, njohuri mbi kontabilitetin e informatizuar, dhe njohuri mbi çështje të etikës, ndërsa në afatmesëm të përfshihet marrja e njohurive lidhur me Fintech.</i></p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Ndarja teori (leksione) dhe praktikë (seminare /laboratore /praktika) në programin e studimit Bachelor në Financë Bankë (shqip) është në raportet 89 % kundrejt 11 %, pra me një përqindje të dukshme në favor të teorisë. <i>(sipas Planit Mësimor të Programit të Studimit dhe përmbledhjes në tabelën 13 në shtojcat e RVB, rezultojnë këto orë mësimore):</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - 1836 orë leksione - 64 orë seminare - 0 orë ushtrime/laboratorë - 2 orë praktikë e zhvilluar në auditor - 98 orë praktika profesionale - 64 orë diploma / provim i përgjithshëm - 2064 orë në total <p><i>Gjatë vizitës në Institucion, GVJ u informua se pavarësisht se emërtoheshin si leksione, në fakt seancat mësimore përfshinin edhe trajtimet e ushtrimeve dhe rasteve. Mbështetur në intervistat e kryera me studentët e programit, GVJ konstaton se aftësimi i studentëve dhe formimi i tyre teorik dhe praktik mundëson vetëm kryesisht arritjen e objektivave formues, transferimin e studimeve si edhe punësim në përfundim të</i></p>

	<p><i>studimeve</i>. Nga ana tjetër praktika profesionale, si një ndër elementet më të rëndësishme të aspektit praktik nuk është një lëndë e detyrueshme, pavarësisht rekomandimeve të dhëna në akreditimin e parë, vazhdon të jetë lëndë me zgjedhje ku vetëm 50% e studentëve e zgjedhin. Megjithatë, sipas RVB studentët angazhohen në trajnime të tjera gjatë studimeve të tyre, të cilat konfirmuar gjatë takimit në Institucion mund të pasurohen më tej.</p>
<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Në lidhje me periodicitetin e përmirësimit të lëndëve dhe moduleve të programit të studimit, RVB e përgatitur nga Institucioni referon se ato azhornohen vazhdimisht bazuar në literaturën e kërkuar dhe të rekomanduar të 5 viteve të fundit dhe referon si informacion mbështetës shtojcat 4, 13 dhe 52, por të cilat, konstatuar nga GVJ nuk referojnë drejtpërdrejt përbushjen ose jo të këtij kriteri.</p> <p><i>Nga shqyrtimi që GVJ i bëri më pas syllabuseve konstatojmë që ky kriter përbushet pjesërisht, pasi literatura e detyrueshme në të gjitha programet lëndore ishte në gjuhën angleze dhe jo në shqip. Rekomandojmë rishikimin e këtij elementi, në vazhdimësi edhe të rekomandimit të papërbushur të akreditimit të mëparshëm.</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Bazuar në analizën që GVJ i bëri tërësisë së syllabuseve të programit të studimit për të tre vitet arrin në përfundimin se në përgjithësi përmbajtja e tyre mundëson kryesisht përfitim të dijeve dhe aftësive nga ana e studentëve të kompetencave teknike të synuara për një program të ciklit të parë. Përsa i përket aftësive teknike në profesion, syllabuset e lëndëve të këtij programi studimi paraqiten kryesisht të kompletuara, me disa përjashtime që nuk çenojnë vlerën totale të përmbajtjes së programit (<i>referoju konstatimeve të listuara në kriterin 4 më lart</i>).</p> <p><i>Cfarë mund të sugjerojmë gjithashtu është që ndër lëndët me zgjedhje të bëhet një zhvendosje nga lëndët me profil administrim biznesi (si e-marketing, menaxhimi total i cilësisë drejt lëndëve me karakter financiar si raportimi tatimor dhe financiar në Shqipëri, kontabiliteti i informatizuar, etika në profesion).</i></p>
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me</p>	<p>Bazuar në analizën që GVJ i bëri syllabuseve të programit të studimit Bachelor në Financë Bankë (shqip) për të tre vitet konstaton se në vija të përgjithshme përmbajtja e programit të studimit mundëson si vijimin e mëtejshëm të studimeve (në</p>

<p>pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>programe brenda dhe jashtë vendit), ashtu edhe punësimin e menjëhershëm të studentëve.</p> <p><i>Megjithatë, në elemente të veçanta, programi ka nevojë të pasurohet në përmbajtjen e syllabuseve të lëndëve që ofron, me fusha dhe tematika të cilat konsiderohen të rëndësishme për përftimin e kompetencave profesionale. Do të listonim edhe njëherë njohuritë nga legjislacioni tatimor në Shqipëri, njohuri për kontabilitetin e informatizuar, çështje të etikës në profesion. Këto elemente do të përgatishin edhe më shumë studentët si për tregun e punës ashtu edhe për vijimin e mëtejshëm të studimeve.</i></p>			
<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Referuar deklarimeve të Institucionit në RVB, është kryer një analizë e punësimit të studentëve dhe kënaqësisë së tyre me programin e studimit (<i>apendiksi nr. 17 në DVV</i>), por linku në RVB të con në një studim të vitit 2017, ndërkohë që appendiksi nr 17 i referohet vitit 2019. Në të dyja rastet, këto studime fokusohen në pyetësorë për studentët e diplomuar dhe jo analizë të propozimeve të palëve të treta, sic e kërkon ky kriter dhe mbi të gjitha, ofrojnë shumë grafikë dhe pak ose aspak analizë që të reflektojë përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit. <i>GVJ nuk ndeshi as dokumenta që të dëshmojnë se strukturat përgjegjëse të Institucionit konsultohen dhe marrin parasysh propozime të bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Sipas RVB të Institucionit për këtë kriter referohet se personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme i angazhuar në realizimin e programit të studimit plotëson kërkesat ligjore në fuqi dhe si referenca jep shtojcat 20, 21, 22, 23 dhe 24 ku 20 dhe 21, nuk gjenden në DVV. G</p> <p>VJ, nga shqyrtimi i tabelave me të dhëna, dhe konkretisht (<i>tabelat 12 në shtojcat e RVB</i>), konstaton se Institucioni përmbush kërkesat e VKM Nr. 418, viti 2017, pasi Stafi</p>



akademik i brendshëm në mënyrë konsistente përballon më shumë se 70% të orëve mësimore të këtij programi studimi, ndërsa stafi akademik me kontratë angazhohet në më pak se 30 % të orëve mësimore të programit të studimit.

Gjithashtu, GVJ, nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar si edhe gjatë vizitave në Institucion konstaton se njësia bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit Bachelor në "Financë Bankë" është Departamenti i Financë Bankës por në mësimdhënie në këtë program studimi angazhohen edhe pedagogë nga njësi të tjera të Institucionit.

Në mënyrë më të detajuar dhe referuar të dhënave (tabela 6, shtojcat e RVB), po paraqesim si më poshtë përbërjen e stafit akademik për të tre vitet akademike:

GJITHSEJ për vitin akademik 2019 – 2020 kanë dhënë mësim **34 pedagogë** nga të cilët **22 PAE** dhe **12 PAK** (në raportet 65%/35%)

PAE:

1 Prof.Dr

3 Prof.As.Dr

11 Dr/PhD

7 Msc

PAK:

1 Prof.Dr

2 Prof.As.Dr

6 Dr/PhD

3 Msc

GJITHSEJ për vitin akademik 2018 – 2019 kanë dhënë mësim **34 pedagogë** nga të cilët **19 PAE** dhe **15 PAK** (56%/44%)

PAE:

1 Prof.Dr

2 Prof.As.Dr

11 Dr/PhD

5 Msc

PAK:

1 Prof.Dr

3 Prof.As.Dr

8 Dr/PhD

3 Msc

GJITHSEJ për vitin akademik 2017 – 2018 kanë dhënë mësim **32 pedagogë** nga të cilët **17 PAE** dhe **15 PAK** (53%/47%)

PAE:

3 Prof.As.Dr

7 Dr/PhD

7 Msc

PAK:

1 Prof.Dr

2 Prof.As.Dr

7 Dr/PhD

5 Msc

	<i>GVJ gjatë shqyrtimit të dokumentacionit pranë zyrës së BNJ konstatoi se një staf PAE i punësuar gjatë vitit akademik 2019-2020 kishte titullin Master Profesional dhe jo Msc, në kundërshtim me Ligjin 80/2015, Neni 59.</i>
Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.	Nga shqyrtimi i të dhënave të personelit akademik të angazhuar në realizimin e programit të studimit GVJ mund të shprehet se fokusi profesional dhe formimi e niveli akademik i tyre është i kënaqshëm për të garantuar mbulimin e programeve dhe moduleve mësimore të programit të studimit. <i>Cfarë konstatohet nga GVJ dhe konfirmohet nga stafi akademik, është numri i lartë i orëve (leksione) dhe i lëndëve mësimore për disa anëtarë të stafit akademik (disa prej tyre janë të angazhuar në mbi 5 – 6 lëndë gjatë vitit akademik.</i>
Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.	GVJ shqyrtoi dokumentacionin dhe CV e personelit akademik të angazhuar me kohë të plotë dhe me kohë të pjesëshme dhe konstaton se pedagogët që janë të angazhuar në lëndë të këtij programi mësimor kanë formimin e duhur por edhe përvojën për të dhënë mësim në ato lëndë të cilat u janë ngarkuar. Ata janë të kualifikuar dhe punojnë në fusha akademike dhe / ose kërkimi në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të vecanta.
Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Dokumentacioni i dorëzuar nga Institucioni tregon një sërë marrëveshje të nënshkruara me biznese të ndryshme me qëllim kryerjen e praktikave mësimore. GVJ, gjatë vizitës në Institucion konfirmoi me studentët mënyrën e instruktimit dhe udhëheqjes së tyre gjatë procesit të përgatitjes së diplomës dhe praktikës profesionale. Në lidhje me punimin e temës së diplomës Institucioni ka një procedurë të mirëpërcaktuar të cilën e referon në Rregulloren Themelore. Gjatë vizitës në Institucion (qershor 2020), GVJ u informua se studentët e vitit të tretë kishin filluar të përgatiteshin për procedurat e diplomimit dhe se ishin të mirë instruktuar për këto procedura, qoftë për provimin e përgjithshëm, ose për përgatitjen e punimit të diplomës.
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve	Orët mësimore të programit të studimit Bachelor në Financë Bankë (shqip) në Universitetin Epoka, ofrohen kryesisht në klasa të pajisura në mënyrë të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor (tabela shënimesh, projektor, kompjuter PC në cdo sallë). Për këtë program studimi orët në laborator nuk



laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	parashikohen në shumicën e programeve lëndore, me përjashtim të lëndëve të statistikës dhe ekonometrisë. Për këtë arsye, edhe në tabelën 2 në shtojcat e RVB vihet re se për asnjë vit akademik, 2017-2018, 2018-2019 dhe 2019-2020 nuk ka personel ndihmës akademik			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	



III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.	Misioni i Universitetit Epoka: "Të jesh një institucion inovativ dhe me ndikim mësimor dhe kërkimor", demonstroi përkushtimin e tij ndaj metodologjive të reja të mësimdhënies dhe kjo theksohet edhe në përparësitë e fakulteteve për periudhën 2018-2020. Plani Strategjik për zhvillimin e Departamentit të Financë Bankës, (<i>apendiksi nr.4 në DVV</i>), i mëshon rëndësi rritjes së cilësisë së mësimdhënies në këtë fushë. Gjatë vizitës në Institucion pedagogët e programit të studimit treguan se janë të nxitur të përdorin metoda të ndryshme për përfshirjen e studentëve në procesin mësimor si diskutimi i rasteve mësimore, ndarja në ekipe pune, etj.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	Duke shqyrtuar dosjen e dokumentacionit GVJ konstaton se janë tre elemente që përdoren nga Institucioni për të kontrolluar aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik: 1) Pyetësorët e zhvilluar me studentët në fund të cdo semestri studimesh; 2) Universiteti ka një Komision i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë i cili ndër të tjera, bën vlerësimin periodik të rezultateve të veprimtarive arsimore dhe kërkimit shkencor. 3) vizitat gjatë procesit mësimor nga ana e përgjegjësave të departamentit dhe / ose dekanit, kryesisht në fillim të vitit akademik ose për ata pedagogë që kanë rezultuar problematikë nga vlerësimi i studentëve. Sic edhe u konfirmua gjatë vizitës në Institucion, rezultatet e vlerësimit diskutoheshin me anëtarët e stafit akademik me qëllim përmirësimin e performancës së tyre dhe në raste të rralla rezultatet e vlerësimit janë marrë parasysh deri në pikën që kanë cuar në mos përsëritjen e kontratës së një stafi PAK.
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e	Gjatë vizitës në Institucion, GVJ diskutoi me studentët në lidhje me përfshirjen e tyre në vlerësimin periodik të formave dhe metodave të mësimdhënies dhe u informua se ata ishin pjesë e rregullt dhe e vazhdueshme e këtij procesi. Gjithashtu

metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	GVJ konstatoi se studentët ishin konfidentë se rastet e ankimimeve nga ana e tyre, pavarësisht se ato (ankimimet) kishin qenë minimale, ishin mirëpritur dhe zgjidhur shpejt nga ana e Institucionit.			
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	<p>Per këtë kriter në RVB deklarohet se ka të dhëna në faqen e internetit të Institucionit, por informacionet më të fundit i përkasin vitit 2017 dhe çfarë gjendet janë raporte të vlerësimit të brendshëm në kuadrin e akreditimeve të ndryshme dhe jo çfarë kërkon konkretisht ky kriter.</p> <p>GVJ konstatoi në DVV se rezultatet e vlerësimit periodik të performancës së programit të Studimit Bachelor në Financë - Bankë janë të përfshira në appendiksin 37.1 dhe 37.2 të përgatitur nga Departamenti i Financë Bankës si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit. Këto dy appendikse ofrojnë të dhëna të paqarta në lidhje me kohën dhe metodologjinë e vlerësimit.</p> <p><i>GVJ është e mendimit se vlerësimi i programit të studimit nuk është realizuar në atë mënyrë që ky kriter e kërkon.</i></p>			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies.	<p>Në RVB të dorëzuar nga Institucioni referohet se si Universiteti ashtu edhe departamenti i Financë-Bankës testojnë vlefshmërinë e teknikave të tyre të mësimdhënies dhe kërkimit dhe nëse është e nevojshme, rregullojnë teknikat e tyre të mësimdhënies dhe kërkimit në përputhje me rrethanat – praktikë që u konfirmua nga GVJ gjatë vizitës në Institucion. Në të njëjtën kohë, Universiteti ofron mbështetje financiare për anëtarët e personelit akademik për të marrë pjesë në konferenca ndërkombëtare dhe ngjarje të tjera shkencore sipas disa procedurave të mirëpërcatuara. (Për kërkimin shkencor jepet: 1 – pjesëmarrje në konferenca ka buxhet; 2 – artikuj të publikuar, nëse publikon me impact faktor merr shpërblim sipas llojit të revistës dhe botimit. Gjithashtu ka edhe mbështetje për kërkime të kryera nga stafi kryesisht për studentët e doktoraturës.)</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Si rregull i përgjithshëm Universiteti Epoka aplikon si forma mësimdhënie leksionet, detyrat e kursit, esetë, projektet, praktikat profesionale (sipas dokumentacionit të dorëzuar nga ana e Universitetit Epoka).</p> <p>Nga shqyrtimi i Planit Mësimor të Programit të Studimit, si edhe e dosjes së syllabuseve, por edhe nga konfirmimet gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstaton se format e mësimdhënies për këtë program specifik janë leksionet, detyrat e kursit/esetë, praktikat profesionale kur ato zgjidhen nga studentët.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në Institucion dhe bisedave me stafin dhe studentët formoi përshtypjen se mes të dy palëve ishte ndërtuar një raport i hapur komunikues. Pedagogët mundoheshin të ofronin sa më shumë raste praktike gjatë orëve mësimore dhe të trajtonin situatë korrente dhe me interes për fushën e financës dhe të bankës. Po kështu edhe studentët u shprehën në përgjithësi konfidentë në lidhje me metodat e mësimdhënies që përdorëshin me ta. I vetmi shqetësim që u ngrit nga studentët e programit të Financë Bankës (shqip) ishte hapësira orare e ndryshueshme gjatë cdo ditë të javës, cka mund të përmirëohet lehtësisht në vazhdimësi.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Universiteti Epoka mbështet personelin e tij akademik për përmirësimin e kompetencave didaktike duke i përfshirë në trajnime që i aftësojnë ata në fushën akademike dhe kjo u konfirmua nga ana e GVJ gjatë diskutimeve me pedagogët e Institucionit.</p> <p>Gjithashtu Universiteti Epoka ka politika fleksibël përsa i përket aplikimit të metodave të larmishme pedagogjike dhe anagzohet seriozisht në kontrollin e këtyre metodave deri edhe duke vizituar lektorët gjatë orëve të mësimi.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Pavarësisht se orët në klasë, konsiderohen të gjitha si leksione në planin mësimor, në të vërtetë u konstatua gjatë diskutimeve me stafin se lektorët përfshijnë në klasat e tyre përdorimin e programeve profesionale, diskutimet në klasë, debatet, ligjëratat e hapura, studimet e çështjeve, prezantimet me gojë, projektet dhe esetë. Studentët e programit të studimit u shprehën të kënaqur me nivelin akademik dhe aftësitë didaktike të demonstruara nga ana e pedagogëve.</p>

<p>Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>GVJ konfirmoi gjatë diskutimeve me stafin e angazhuar në program se Institucioni aplikonte si praktikë pune zgjedhjen e rastësishme nga ana e Dekanit të auditorëve që duhen monitoruar dhe vlerësuar. Pas këtyre seancave dëgjimore bëhej vlerësimi për aftësitë didaktike të pedagogut. Procesi i vlerësimit të pedagogëve përfshin edhe studentët nëpërmjet pyetësorëve të cilët ata i plotësojnë në mënyrë elektronike dhe anonime në fund të çdo semestri. Gjithashtu, GVJ konfirmoi me studentët gjatë vizitës në Institucion se ata inkurajohen të japin sugjerimet e tyre mbi kriteret e vlerësimit të kursit para se kjo e fundit të finalizohet në sistem (d.m.th. java e parë e semestrit përkatës kur bëhet edhe prezantimi i syllabuseve).</p>			
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.</p>	<p>Duke qenë se GVJ vëren se në Planin Mësimor të Programit të Studimit ka kryesisht leksione dhe pak ose aspak seminare dhe se në RVB të plotësuar nga ana e Institucionit deklarohet se një qasje komunikimi e dyanshme ndiqet nga të gjithë lektorët e këtij programi studimi, u pyetën pedagogët sesi mundën t'i bëjnë tërheqëse orët e mësimit, pedagogët e angazhuar në këtë program, u shprehën se ata kanë liri që të organizojnë studentët në grupe pune dhe i angazhojnë ata në diskutime mes njëri tjetrit.</p>			
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Bazuar në pyetje drejtuar studentëve të programit të studimit GVJ konstaton se një ndër format e mësimdhënies të zbatuara nga pedagogët e Institucionit që i nxisin studentët të marrin pjesë aktive dhe të reflektojnë në mësimdhënie, është caktimi i përgjegjësive për detyra specifike për secilin prej studentëve duke i nxitur kështu që të fitojnë aftësi shprehëse dhe argumentuese edhe në debatin mes njëri tjetrit. Në përgjithësi GVJ formoi opinionin se kjo metodë mësimdhënie, inkurajon të menduarin e pavarur dhe kritik nga ana e studentëve.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në</p>	<p>Pas verifikimit të dokumentacionit dhe sidomos gjatë konstatimeve gjatë vizitës në Institucion GVJ konstaton se</p>

<p>hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>Universiteti Epoka ofron mjedise me infrastrukturën e nevojshme, (ndricim, sistem kondicionimi, ujë, ëireless, bibliotekë për të lexuar apo studiuar dhe laboratorë) për të realizuar procesin mësimor. Vetë studentët vlerësuan vendndodhjen dhe hapësirat e ofruara nga Institucioni. Largësia nga qyteti ishte një çështje që Institucioni e ka zgjidhur duke ofruar transport urban.</p>
<p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>Në Universitetin Epoka klasat janë të pajisura me mjetet e nevojshme për të bërë funksional procesin mësimor, si kompjuterat, projektorë, tabela shënimesh Smart, etj. Kompjuterët në klasë dhe kompjuterët e vendosur në laboratorë përmbanin softuerët e nevojshëm, programet dhe paketat e nevojshme në lëndë specifike të këtij programi studimi si: Windows, MS Office, Adobe Reader, SPSS, E-Views 9, STATA, etj. GVJ konstatoi funksionimin e programit Financa 5 ndëra programi tjetër i adminsitrimin të informacionit financiar, Alpha web funksionon në bazë cloud dhe nuk ishte i nevojshëm të instalohet në kompjuterat e laboratorit.</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>Në ambientet e Institucionit funksionon rrjeti wireless ku ka akses cdo student, dhe qasje në sistemin e informacionit në ambientet e Universitetit por edhe jashtë tij. Paketat softuerike të përdorura për qëllime të mësimdhënies janë Windows, MS Office, Adobe Reader, SPSS, E-Views 9, STATA, etj.</p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohuri të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Në programet lëndore, GVJ konstaton se ofrohen tituj të mjaftueshëm në literaturën bazë dhe ndihmëse të vënë në dispozicion të studentëve, <i>por këto tituj ishin kryesisht në gjuhën angleze që nuk është gjuha e programit të studimit (konfirmuar kjo edhe nga shtojca 45 në DVV – Tekstet e Departamentit Financë – Bankë).</i></p> <p>Në RVB referohet se kombinimi i literaturës ndërkombëtare dhe teksteve shkollore kombëtare e bën këtë program studimi konkurrues në treg pasi ofron mundësinë e një letërsie dhe materialeve mësimore të azhornuar. Të pyetur gjatë vizitës në Institucion, studentët u shprehën se literatura është kryesisht në gjuhën shqip por vetëm slidet dhe përmbledhjet e përgatitura nga pedagogët.</p> <p><i>Tekstet e plota ishin kryesisht në gjuhën angleze dhe GVJ është skeptike nëse studentët arrinin të lexonin lehtësisht tekstet e plota apo i marrin njohuritë të reduktuara vetëm nga slide dhe përmbledhje përgatitur nga pedagogët.</i></p>

<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>GVJ konstatoi gjatë vizitës në Institucion, se biblioteka e Universitetit Epoka ka hapësira të bollshme dhe përbante burime elektronike dhe kopje fizike të literaturës së sugjeruar, <i>por gjithmonë në gjuhën angleze dhe jo atë shqip që është edhe gjuha e këtij programi studimi.</i> Materialet e bibliotekës mund të përdoren ose në mjedisin e bibliotekës, ose mund të huazohen për përdorim të jashtëm. Biblioteka paraqitet e pasur në tituj virtualë si edhe në aksesin në botime periodike të fushës.</p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Universiteti Epoka ka akses në bibliotekat online si JSTOR, një bibliotekë që përfshin më shumë se 2 000 revista akademike dhe shkencore, dhe disa burime të tjera në internet si: Bio One, Cambridge Journals Online, eLibrary Academic Complete, EBSCO Academic Search Complete, Emerald Management e-Journal Collection, IOP science, MultiScience Journals Collection, OECD e-Library, Oxford English Dictionary Online, Oxford Reference Online, ProQuest Central, Taylor and Francis Library (sipas RVB).</p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>GVJ konstatoi se shumë prej programeve lëndore përmbanin si detyrim të lëndës dhe element vlerësimi përgatitjen e detyrave dhe projekteve të kursit. Laboratorët e Institucionit u verifikua se janë funksionale dhe ofrojnë mundësi që studentët të përgatisin projektet, detyrat dhe kërkesat e tjera të programit mësimor. Orari i shfrytëzimit të tre laboratorëve ishte gjatë gjithë javës.</p>
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>GVJ konstaton se Universiteti Epoka përdor kryesisht dy platforma të rëndësishme në funksion të mësimdhënies (bazuar në shqyrtimin e DVV, si edhe konfirmuar gjatë vizitës në Institucion):</p> <p>1 – Platforma Learning Management System (LMS) me bazë në Moodle për koordinimin dhe organizmin e lëndëve online 2- Softuerin Turnitin që ndihmon përdoruesit të kuptojnë dhe shmangin plagjiaturën dhe të zhvillojnë të kuptuarit e tyre se si të citojnë burimet si pjesë e një argumenti akademik.</p>
<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.</p>	<p>Universiteti Epoka përdor sistemin e informacionit EIS (Epoka Interactive System) i cili është një sistem interaktiv online ku përdoruesit mund të regjistrohen duke përdorur llogarinë e emailit. Është një sistem modular i organizuar nga role dhe njësi përkatëse në universitet që ruan informacionin në një bazë të dhënash të centralizuar. Të gjithë përdoruesit mund të: përdorin informacionin e tyre personal, përditësojnë detaje të përgjithshme dhe CV dhe mund të menaxhojnë detyra dhe aktivitete që lidhen me punën sipas rolit të tyre dhe</p>

	pozicionit të punës. Nga intervistat e zhvilluara me personelin akademik dhe me studentët u mësua se sistemi EIS ishte gjerësisht i përdorur nga të dyja palët për të mirë koordinuar hapat gjatë semestrit, si materialet mësimore, vlerësimet gjatë vitit dhe ato përfundimtare, etj.			
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Sipas Rregullores së programit të studimit, GVJ konstatoi se studentët e programit të studimit Bachelor në Financë-Bankë (shqip) të cilët kanë një mesatare mbi 3 (GPA) përgatisin projektin e diplomimit. Projektet e diplomimit mbulojnë tema kryesisht në fushat e studimit Financë dhe Bankë të cilat specifikohen pas konsultimeve të vazhdueshme të studentëve me mbikëqyrësit. Cdo mbikëqyrës i caktuar për projektet e diplomimit organizon të paktën dy takime/prezantime me studentët pra arrin të ndjekë ecurinë e studentëve gjatë përgatitjes së projektit të diplomës. Gjatë prezantimit të parë studentët japin një propozim dhe marrin sygjerime mbi temat e zgjedhura, ndërsa gjatë prezantimit të dytë studentët japin një përmbledhje të rishikimit të literaturës dhe metodologjisë së studimit të tyre, si dhe rezultateve nga analiza e tyre.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	GVJ, mbështetur në dokumentacionin pjesë e DVV, konstaton ngritjen e dy strukturave të cilat bashkëpunojnë për promovimin e përmirësimit të vazhdueshëm dhe garantimin e cilësisë së mësimdhënies në Universitetin Epoka. Senati Akademik i Universitetit ka krijuar Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë në përputhje me Legjislacionin e Arsimit të Lartë. Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë (KPSC) dhe Zyra e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë (ZBSC) përbëjnë Njësinë e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë të Universitetit (Rregullorja për Organizimin dhe Funkionimin e Manualit të Sigurimit të Cilësisë KPSC; Manuali i Sigurimit të Cilësisë të Universitetit Epoka). Universiteti identifikon ndryshimet për të siguruar suksesin e vazhdueshëm të

	<p>programit të studimit edhe përmes rishikimit vjetor të performancës së programit të studimit, si edhe shqyrtimit të anketave të vlerësimit nga ana e studentëve.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Sipas Politikës "Për përmirësimin e Vazhdueshëm të Programeve të Studimit, (<i>shtojca 8 në DVV</i>), konstaton se departamenti është njësia bazë përgjegjëse për programet e studimit që ofron, që nga përzgjedhja e personelit akademik që angazhohet në mësimdhënie e deri tek shpërndarja optimale e ngarkesës mësimore. Nga vizita në Institucion, GVJ-së iu konfirmua se është Përgjegjësi i departamentit ai që së bashku me Dekanin miraton syllabuset e hartuara dhe bën vlerësimin e mësimdhënies. Stafi i departamentit dhe studentët janë në dijeni qysh në fillim të vitit akademik që do i nënshtrohen një procesi të vlerësimit të procesit mësimor.</p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Politika e Institucionit Epoka është punësimi i personelit të larmishëm akademik, nga vende të ndryshme, prejardhje dhe kultura, duke pasuruar kështu programet me metoda të reja mësimore (<i>sipas RVB në lidhje me këtë kriter</i>). Departamentet mirëpresin sugjerimet e lektorëve në lidhje me metodat inovative të mësimdhënies dhe sigurohen që të ofrojnë mbështetje maksimale për stimuj dhe qasje të tilla. Të pyetur për këto qasje, kjo u konfirmua edhe nga stafi akademik gjatë vizitës në Institucion.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Nga shqyrtimi i materialeve të dorëzuara si pjesë e DVV, konstatohet nga ana e GVJ se raportohet që personeli akademik kualifikohet në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor sidomos duke u inkurajuar të marrin pjesë në projekte shkencore. Pjesëmarrja në konferenca ndërkombëtare, në projekte si dhe botime shkencore të stafit gjenden në tërësinë e dokumentacionit të dorëzuar dhe sikurse është referuar edhe më lart në këtë raport mbështetet financiarisht, mbështetje që përshkallëzohet sipas suksesit dhe cilësisë që demonstroi cdo pedagog.</p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Një nga objektivat kryesore të Universitetit (<i>sic shprehet RVB për këtë kriter</i>) është edhe përmirësimi i vazhdueshëm i veprimtarive mësimdhënëse dhe mësimnxënëse si dhe adoptimi i metodave inovative është. Por materiali që referohet nga RVB të con në një trajnim të vitit 2017. Gjatë vizitës në Institucion dhe diskutimeve me stafin GVJ, mësoi se ata angazhohen në mënyrë periodike në trajnime të ndryshme. Në vitin e fundit pedagogët kanë marrë pjesë në trajnime për përgatitje dhe pjesëmarrje në projekte si edhe në përmirësimin</p>

	e aftësive për përgatitjen e syllabuseve. Për këtë arsye GVJ është e opinionit se ky kriter përmbushet.			
Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	GVJ u informua gjatë diskutimeve me personelin akademik të angazhuar me këtë program mësimor në vizitën në Institucion, se personeli akademik përgjegjës për zbatimin e programit të studimit u kërkojnë studentëve që të japin sugjerime për organizimin e lëndës pasi të paraqitet syllabusi i lëndës përkatëse në klasë. Nëse sugjerimet vlerësohen si të dobishme për përmirësimin e mësimdhënies, lektori siguron zbatimin e metodave të kërkuara. Gjithashtu pjesëmarrja e tyre në konferenca dhe trajnime konfirmon qasjen pozitive që kanë për përmirësimin e metodave të mësimdhënies.			
Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	Sipas diskutimeve me anëtarë të personelit akademik gjatë vizitës në Institucion, personeli akademik nxiten të testojnë metoda të reja në mësimdhënie dhe të analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për to. Çdo vit, gjatë rishikimit të syllabuseve ekziston mundësia për implementimin e metodave të reja të mësimdhënies dhe kjo u konfirmua nga vetë pedagogët e lëndës para GVJ.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	GVJ konstatoi se mënyra e testimit të njohurive të studentëve përcaktohet në “Rregulloren e Programit të Studimit Bachelor dhe mbi zhvillimin e provimeve”. (shtojca 7 në DVV). Kjo rregullore është e publikuar në faqen e internetit të Institucionit dhe sic u verifikua edhe nga GVJ gjatë vizitës në Institucion, studentët njihen me këto mënyra edhe për shkak të faktit se përfshihen në syllabuse të lëndëve mësimore dhe diskutohen në javën e parë të cdo semestri madje duke u dhënë mundësi edhe të përmirëojnë elemente të caktuara në këtë mënyrë vlerësimi.

<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Nga diskutimet me studentët e programit të studimit GVJ konstatoi se ata njihen në fillim të çdo lëndë/moduli me metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. Studentët kishin mundësi të sugjeronin përshtatje modeste të mënyrës së vlerësimit përpara se syllabusi të ngarkohej në sistemin elektronik të menaxhimit të mësimin ku ishin të aksesueshme gjatë gjithë mësimin.</p>			
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>GVJ pasi shqyrtoi syllabuset e lëndëve vërejtë se në to ka elemente të larmishme të kontrollit dhe vlerësimit të njohurive si: provimet dhe testimet e ndërmjetme dhe përfundimtare, detyrat e kursit dhe niveli i aktivizimit në seminare apo punë laboratorike, vlerësimet mbi bazën e përgjigjeve të sakta, etj. GVJ gjykon se përfshirja e një larmie të formave të vlerësimit u jep mundësinë të gjithë studentëve të shprehin format e vecanta të aftësive dhe talenteve të tyre dhe të mbrojnë kompetencat e fituara gjatë zhvillimit të procesit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Standardi III.6 Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.</p>	<p>GVJ ka konstatuar (nga programet lëndore) se vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm gjatë gjithë periudhës mësimore dhe vitit akademik dhe është rezultante e këtyre elementeve (përgjithësisht) të shtira gjatë gjithë vitit akademik (provime të ndërmjetëm, kuicet, praktikat, detyrat, projektet, seminarët, pjesëmarrjen, studime laboratorike).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>E vetmja formë elektronike testimi që GVJ ndeshi gjatë shqyrtimit të dokumentacionit dhe edhe konfirmuar nga diskutimet me pedagogët, ishte përdorimi i platformës Turnitin, e cila përveç mënjanimit të plagjiaturës që është qëllimi primar për të cilin përdoret, nxit vlerësimin transparent dhe eviton abuzimin.</p>



	<i>Institucioni nuk përdor metoda apo sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit.</i>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësiwe profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	<i>Sic verifikohet nga dokumentacioni në DVV, në Universitetin Epoka provimet realizohen nga lektorët e lëndëve (titullarët e lëndëve nuk janë të përcaktuar) dhe vetëm projekti i diplomës realizohet me një komision provimi. Të pyetur gjatë vizitës në Institucion, ky fakt u pohua nga ana e pedagogëve të Departamentit të Financë-Bankës i cili është njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit.</i>
Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.	<i>GVJ konstatoi se ambientet e Universitetit Epoka ku zhvillohen teste janë të vrojuara pasi janë të pajisura me kamera sigurie. Gjithashtu, në vitin e fundit akademik 2019-2020 Universiteti Epoka ka implementuar një skemë anonimati për provimet me shkrim. Para provimeve, të gjithë studentëve u lëshohet ID e Studentit të Provimit, e cila duhet të shkruhet në hapësirën e duhur në fletën e provimit. Këto ID u shpërndahen në mënyrë elektronike çdo studenti përmes llogarive personale të EIS. Të pyetur gjatë vizitës në Institucion, kjo procedurë konfirmohet nga studentët dhe pedagogët e programit të studimit.</i>
Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësiwe profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	<i>Vlerësimi i njohurive në provime dhe teste, është i shoqëruar me komentet përkatëse të vlerësimit në mënyrë që studenti të jetë sa më i qartë dhe i vetëdijshëm për gabimet a pasaktësitë e tij (<i>sipas RVB për këtë kriter</i>). Gjithashtu, provimi i ndërmjetëm zgjidhet në klasë në javën pasi është zhvilluar. Të pyetur gjatë vizitës në Institucion, kjo procedurë konfirmohet nga studentët të cilët u shprehën se në cdo rast, vlerësimet e provimeve të tyre ishin të argumentuara nga ana e pedagogëve dhe ata ishin të qartë për pikat ku kishin nevojë të përmirësohen.</i>
Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.	<i>Kodi i Etikës, dhe Rregullorja mbi Provimet”, parashikojnë masa të rrepta për të shmangur plagjiaturën dhe për të marrë masa disiplinore në raste kopjimi. Gjithashtu, përdorimi i platformës Turnitin”, lehtëson këtë proces duke disiplinuar studentët. Lektorit përkatës i lëndës përcakton një prag për përqindjen e plagjiaturës që lejohet në punimin e studentëve. Në rast mosrespektimi, studentët marrin një notë jo kalues dhe një paralajmërim verbal ose me shkrim. Të pyetur për reagimin dhe masat e marra në situata të tilla, konkrete pedagogët nuk ngurren të argumentojnë përse e konsiderojnë të rëndësishëm kultivimin e kulturës antiplagjiaturë duke u treguar kategorikë për të refuzuar pajtimin me këto praktika në rast konstatimi të tyre.</i>

<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësiwe profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Konfirmuar gjatë vizitës në Institucion, dhe në mbështetje të Rregulloreve të Institucionit, procedura e publikimit të rezultateve të kontrollit parashikon afate të cilat në përgjithësi ndiqen nga ana e Departamentit. Të gjithë lektorëve u kërkohet të vendosin notat në sistemin EIS brenda një periudhe një javore.</p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>GVJ konstaton (Rregullorja mbi provimet) se nëse pasi të vendoset nota përfundimtare për lëndën, studenti kërkon që të vlerësohet vlerësimi i një lënde të caktuar, atëherë ndiqet një procedurë e paracaktuar për rishikimin e vlerësimit. Gjatë diskutimeve me studentët ata u shprehën se e kanë shfrytëzuar të drejtën e rishikimit të vlerësimit dhe kanë gjetur përkrahjen e pedagogëve për të ushtruar këtë të drejtë të tyre.</p>			
<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Cdo rast ankimimi nga student, ky i fundit duhet të plotësojë dhe dorëzojë një Kërkesë për Ankesë të Notës në Zyrën e Sekretarisë Mësimore brenda pesë ditëve nga shpallja e notave të provimit. Kundërshtimi vlerësohet nga lektori përkatës në lidhje me gabimet materiale. Kërkesa përfundohet nga Dekanati përkatës me një propozim të departamentit që ofron lëndën. Studentëve, për secilën lëndë që kanë marrë, u jepet një notë përfundimtare që tregon shkallën në të cilën studentit ka performuar në lëndën përkatëse. Pyetjet gjatë vizitës në Institucion konfirmojnë procedurën e përshkruar më lart.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësiwe krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Sipas programeve lëndore realizimi dhe zhvillimi i programit të studimit Bachelor në Financë Bankë (shqip) në Universitetin Epoka mundësohet nga një kombinim i mënyrave të ndryshme të mësimdhënies si shembuj; pyetje kritike për problemzgjdhje; raste studimore; analizë e artikujve shkencorë. Kombinimi i këtyre teknikave u jep mundësinë studentëve të njohin teorikisht dhe praktikisht</p>

	fushën ku studiojnë dhe të zhvillojnë aftësi të shëndosha profesionale ndaj GVJ formoi opinionin se kriter përmbushet.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	GVJ konstaton <i>(nga shqyrtimi i Planit Mësimor dhe i syllabuseve të Programit të Studimit,)</i> se ky program mundëson thellimin e njohurive në mënyrë të përgjithshme në fushën e teknologjisë së informacionit (njohuri mbi disa programe kompjuterike, bazë dhe specifike) si edhe në aspektet e komunikimit dhe ndërveprimit (disa lëndë në Programin Mësimor që vendosin theksin në zhvillimin e aftësive për shkrim dhe lexim). <i>GVJ rekomandon se më shumë mund të bëhet në drejtim të programeve të vecanta kompjuterike në fushën e kontabilitetit të cilat për momentin ofrohen vetëm si trajnime, apo edhe të etikës, e cila aktualisht nuk është pjesë përbërëse e Planit Mësimor.</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	Në programet lëndore, GVJ vrojton se përfshihet një element të rëndësishëm i cili është “Learning Outcomes” (Rezultatet e të nxënit nga studentët) dhe që tregon përfitimet nga cdo lëndë. Si GVJ gjykojmë se përfshirja e këtij elementi në syllabus, orienton drejtimin dhe zhvillimin e lëndëve.
Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.	Lektorët e cdo lënde organizojnë klase përsëritjeje të programit në javën e 7-të dhe 14-të të semestrit pra para provimeve përkatëse të ndërmjetme dhe finale (kjo sipas RVB). GVJ gjatë vizitës në Institucion, konfirmon këtë praktikë e cila u konsiderua orientuese dhe vlerështuese nga ana e studentëve për qëllime të provimit por edhe në përgjithësi si përmbledhje.
Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Sipas RVB, pedagogët e lëndëve nxiten që nëse ndodh një ngjarje në tregjet vendore ose ndërkombëtare, e cila konsiderohet e rëndësishme për studentët në Financë-Bankë (shqip), atëherë bëhet një mësim ose një analizë e tij në klasë nga lektori në bashkëpunim me studentët. Gjatë vizitës në Institucion, GVJ konfirmoi vlerën e kësaj praktike për studentët e këtij programi studimi specifik të cilët megjithatë u shprehën se do të dëshironin edhe më shumë intesnitete të orëve të hapura apo të lektorëve të ftuar. <i>Sikurse specifikon tabela nr. 20 në shtojcat e RVB, janë organizuar 25 leksione ose 150 orë me lektorë të ftuar gjatë 5 viteve të fundit, por diskutimet me studentët e programit Bachelor në Financë Bankë (shqip) dëshmojnë që ata nuk kanë një ekspozim të lartë ndaj orëve të tilla.</i>



<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Sipas RVB, ka lëndë të caktuara (p.sh. Ekonometria Financiare dhe Statistikat) të cilat kombinojnë orët teorike me seancat laboratorike çdo javë, por kjo nuk evidentohet në Planin Mësimor të programit të studimit (<i>tabela 10 në shtojcat e RVB</i>) ku edhe për këto lëndë ka vetëm orë leksione. Praktika profesionale është një lëndë me zgjedhje e cila zhvillohet në semestrin e pestë, dhe rreth gjysma e studentëve arrin të zhvillojë gjatë praktikës njohuritë e marra. Gjatë vizitës në Institucion GVJ pati mundësinë të konfirmojë kryerjen e praktikave profesionale.</p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>GVJ, bazuar në analizën e bërë mbi syllabuset e Programit të Studimit, evidenton se në këtë program studimi preferohet puna në ekip e studentëve, si mënyrë inkurajimi e zgjidhjeve inovatore të problematikave të caktuara. Nga vizita në Institucion, një praktikë e tillë u konfirmua edhe nga studentët të cilët u shprehën se kjo i kishte aftësuar të ishin më interaktiv në klasë dhe jashtë saj.</p>
<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.</p>	<p>GVJ konstaton se stafi pedagogjik (nga intervistat e kryera me personelin akademik të Programit të Studimit) janë të gatshëm të krijojnë klimë inkurajuese në favor të ideve inovatore dhe studimeve të avancuara nga ana e studentëve. Vetë studentët u shprehën se ata inkurajohen vazhdimisht të eksplorojnë tema të ndryshme kërkimore aktuale, nëpërmjet ofrimit të logjistikës laboratorike, apo mbështetjes për pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme.</p>
<p>Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.</p>	<p>Në RVB, Institucioni deklaron se organizon në mënyrë të rregullt workshope, konferenca, trajnime profesionale dhe gara të ndryshme (të tilla si: konkurs për ese, ide start-up më të mira, trajnime të Financave 5, etj. duke inkurajuar kështu mendimin kritik të studentëve dhe përfshirjen në aktivitete akademike më rëndësi të madhe.</p> <p>Gjatë vizitës në Institucion, studentët përmenden vetëm anagzhimin në klubin e financës dhe GVJ formoi bindjen se këto evente ishin relativisht më të rralla për programin e studimit Bachelor në Financë Bankë (shqip).</p>
<p>Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Marrëveshjet me institucionet bashkëpunuese në favor të këtij programi studimi u kërkuan gjatë vizitës në Institucion. Për këtë program studimi nuk ka pasur mobilitete të studentëve por disa mobilitete të stafit të anagzhuar me programin. Të dhënat u siguruan pas vizitës në Institucion. Nga shqyrtimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit si edhe dosjes së eventeve të organizuara vihet re se Institucioni ka nënshkruar një numër</p>

	të konsiderueshëm marrëveshesh në fushën e kërkimit shkencor, shkëmbim të stafit akademik dhe të studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.8	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	<p>Për procesin e diplomimit studentët e Programit Bachelor në Financë Bankë (shqip) i nënshtrohen ose një provimi të përgjithshëm, ose përgatisin një punim diplome (nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në DVV). Studentët të cilët kanë një mesatare të përgjithshme nën 3 ose më të lartë në fund të semestrit të 5-të të studimeve, i nënshtrohen procedurave të ndryshme që çojnë në diplomim, procedura të cilat specifikohen në Rregulloret e Institucionit (<i>Rregullorja mbi programet Bachelor dhe Rregullorja mbi Provimet</i>).</p> <p>Sipas këtyre procedurave studentët që diplomohen, janë ata të cilët marrin të paktën 60 nga 100 pikë në provimin përfundimtar gjithëpërfshirës ose ata që përgatitin dhe mbrojnë një tezë që vlerësohet si e suksesshme nga komisioni.</p>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Në RVB të përgatitur nga Institucioni shpjegohet në mënyrë të detajuar procedura e ndjekur për diplomimin, qoftë për studentët që i nënshtrohen një provimi të përgjithshëm, qoftë për studentët të cilët përgatisin një temë diplome. Procedura për cilëndo përjasje parashikon asistencë nga pedagogët, udhëzime të qarta për studentët dhe materiale ndihmëse në funksion të këtij procesi. Të pyetur gjatë vizitës në Institucion, studentët e vitit të fundit të cilët janë aktualisht në process diplomimi konfirmojnë mbështetjen nga personeli akademik dhe Institucioni në përgjithësi.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të	Sipas të dhënave të RVB të Institucionit provimi përfundimtar gjithëpërfshirës është një përmbledhje nga disa nga lëndët kryesore që studentët kanë marrë gjatë studimeve të tyre në programin e studimit Bachelor në Financë-Bankë (shqip). Provimi mbulon pyetje nga lëndët: Mikroekonomia, Makroekonomia, Statistikat, Ekonometria Financiare, Menaxhimi Financiar, Institucionet Financiare dhe Tregjet,

rëndësisë dhe peshës specifike.	Financat e Korporatave, Financat Publike dhe Kontabiliteti Financiar. Gjatë vizitës në Institucion GVJ pyeti për këtë provim dhe iu konfirmua kjo procedure.
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.	Në mbështetje të bisedave me studentët gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstatoi se ata ishin të asistuar nga personeli akademik gjatë procesit të diplomimit, edhe kur i nënshtroheshin një provimi të përgjithshëm, dhe sidomos nëse përgatisnin një punim diplome, rast në të cilin cdo studenti i caktohej një pedagog mbikëqyrës që e ndiqte vazhdimisht ecurinë e tij.
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Në mbështetje të bisedave me studentët gjatë vizitës në Institucion, GVJ u informua se në këtë proces, Institucioni kishte vendosur në dispozicion, jo vetem lehtësira infrastrukturore, por edhe aksesin në bibliotekën online. Gjithashtu pedagogët u shprehën të gatshëm të orientonin studentët jo vetëm në literaturë por edhe në hapat e nevojshme gjatë procesit të mbledhjes dhe analizës së të dhënave.
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Mbështetur në dokumentacionin e dorëzuar, (dhe sic u konfirmua edhe nga studentët që aktualisht punonin me temën e diplomës), udhëheqësi i diplomës asiston studentin në cdo fazë të punimit të temës së diplomës duke nisur nga nxjerrja e rezultateve, përpunimi i tyre, si dhe shkrimi i temës sipas udhëzuesve të miratuar (ka disa dokumente të cilat orientojnë studentët për këtë proces, shiko kriteri 1 më lart). Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit. Pa miratimin e udhëheqësit të diplomës, studentët nuk mund të dorëzojnë punimet e tyre. Udhëheqësi i diplomës takohet disa herë gjatë semestrit me pedagogun për të ndjekur së bashku ecurinë e punimit të temës.
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Në lidhje me këtë kriter, GVJ gjatë punës së tij dhe bazuar në RVB konstatoi se provimi vlerësohet nga FF në AA kurse punimi i diplomës vlerësohet me pikë dhe bazuar dhe në planin mësimor është 6 ECTS.
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Me marrjen e vlerësimit të provimit ose punimit të diplomës, studentët e programit të studimit fitojnë të drejtën e marrjes së diplomës "Bachelor" dhe pajisen përveçse me diplomën, edhe me suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Sic konfirmohet gjatë vizitës në Institucion, kjo procedurë realizohet nga Sekretaria Mësimore nëpërmjet sistemit EIS.




<p>Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në dokumentacionin e dorëzuar nga Institucioni (RVB) specifikohet se në përfundim të studimeve, studenti pajiset, përveç diplomës edhe me suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin (të dhënat për diplomën dhe suplementin e diplomës gjenden në DVV). Bashkë me këtë i jepet edhe një kopje e planit mësimor i cili tregon në mënyrë të qartë të gjitha lëndët e detyrueshme dhe me zgjedhje të marra nga studenti gjatë gjithë kohëzgjatjes së studimeve, notën përfundimtare, kredite dhe ECTS përkatëse për secilën lëndë.</p>			
<p>Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.</p>	<p>GVJ konfirmoi gjatë visitës se Institucioni ruante të dhënat për studentët në format hard copy. GVJ kontrolloi me zgjedhje dosjet e disa studentëve dhe konfirmon se Institucioni ka ruajtur kopje të dokumentacionit të studentit si formulari i regjistrimit, e të dhëna të tjera të mëpasshme gjatë studimeve të tij.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<p>Standardi IV.1 Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në</p>	<p>Departamenti Financë Bankë përcakton nevojat dhe i përcjell përmes Dekanit në Rektorat, procesi i rekrutimit të personelit akademik efektiv apo me kontratë dhe të ftuar koordinohet nga Zyra e Burimeve Njerëzore. ZBNJ përsa i përket</p>



programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.

mbledhjes së të dhënave për personelin akademik me kohë të plotë dhe personelin akademik me kohë të pjesshme zbaton Formularin e Info Staff i cili plotësohet nga stafi i universitetit me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme. Formulari bazohet në udhëzimin e Komisionerit Publik për "Të drejtat e informacionit dhe mbrojtjen e të dhënave personale".

Sipas të dhënave shtesë të depozituara nga IAL pas vizitës dhe pyetjeve të ngritura evidentohet (*Evidenca 6.1 dhe 6.2*) se Koordinatorin e këtij Programi studimi është ende i paemëruar pasi Koordinatorin e mëparshëm është emëruar si Përgjegjës Departamenti që prej Shkurt 2020.

Sipas RVB ruajtja e të dhënave të stafit organizohet duke mbajtur një skedar fizik personal për secilin anëtar të stafit të UE, dhe përveç kësaj duke mbajtur një skedar elektronik në Sistemin Interaktiv të Epokës, që përditësohet në bazë të informacionit të paraqitur pranë BNJ nga çdo anëtar i stafit të UE më parë deri në fillimin e punësimit të tyre si një staf me kohë të plotë ose të pjesshme.

Gjatë vizitës në vend u evidentua për mos mbajtjen e dokumentave origjinale apo të noterizuara në dosjtë e BNJ dhe aty na u bë me dije se dokumentacioni origjinal apo i noterizuar mbahej pranë departamentit ligjor, ndërsa BNJ mbante vetëm fotokopje të tyre.

Nga dosjet e personelit akademik të shqyrtuara (2 dosje PAE dhe 2 dosje PAK) u evidentua se kishte dosje me dokumentacion të pa-azhurnuar. Në 2 prej tyre nuk gjendeshin diplomat e nivelit bachelor dhe listat e notave por vetëm diploma e nivelit Master Shkencor. Një prej tyre ishte vetëm me Master Profesional dhe pa grada shkencore. Gjithashtu, u evidentuan punësime në kundërshtim me rekomandimin e dhënë nga komisioni ad-hoc. Gjithashtu, dosjet e stafit nuk përmbanin informacion lidhur me angazhimin e çdo PAE apo PAK në çdo semestër dhe vit akademik.

Rekomandohet IAL-së:

- të emëroj Koordinatorin e Programit,
- të plotësoj kriteret e rekrutimit me kriterin e diplomës Bachelor dhe notën mesatare për PAE/PAK pa grada shkencore apo tituj
- të respektohen vlerësimet e komisionit Ad-hoc;
- të axhurnohen dosjet e PAE/PAK

<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Në Rregulloren e brendshme "Për rekrutimin e stafit" të UE gjenden të pasqyruara kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta për kategoritë asistent lektor, lektor dhe profesor. Në këto kritere nuk përfshihet nota mesatare e ciklit të parë dhe të dytë të studimeve. Në këto kritere përfshihen përvoja e punës në mësimdhënie, kualifikime brenda apo jashtë vendit, njohuri të gjuhëve të huaja, aktiviteti botues shkencor, etj. Të gjitha këto kritere shoqërohen me pikët respektive për procesin e vlerësimit që kryhet nga komisioni Ad-hoc.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Sipas RVB-së, procedurat e rekrutimit të stafit në UE rregullohen me Rregulloren e brendshme "Për rekrutimin e stafit" të UE dhe në përputhje me Statutin e Universitetit, por GVJ nuk evidenton referenca të drejtpërdrejta të statutit në këtë rregullore, si edhe GVB nuk ka dhënë asnjë referencë të drejtpërdrejtë të statutit në përgjigjet e tyre për kriteret në RVB. Gjatë vizitës në IAL përfaqësuesi i DBNJ u pyet për referencat në statutin e UE lidhur me rekrutimin si edhe <i>për arsyen e mungesës së kriterit të diplomës bachelor dhe mesataren e notave për PAE dhe PAK kur ata nuk kanë një gradë shkencore apo tituj, por nuk u mor përgjigje.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Para fillimit të vitit të ri akademik bazuar në nevojat e Departamentit të Financë Bankë për PAE dhe PAK përcillet kërkesa për miratim në Bordin Administrativ. Është Zyra e Burimeve Njerëzore e cila procedon me hapat e mëtejshëm pasi vendoset miratimi për pozicione vakant nga Bordi Administrativ.</p> <p>Në praktikat më të fundit të rekrutimit të PAE-ve të verifikuar gjatë vizitës në IAL, u evidentua se numri i aplikantëve të trajtuar në procesin e vlerësimit ishte pak më shumë se pozicionet vakante të publikuara. UE për publikun përcjell imazhin e një IAL-je të konsoliduar dhe si e tillë duhet të kujdeset të rekrutojë vetëm staf akademik me grada shkencore dhe tituj akademik.</p> <p><i>GVJ referuar të gjitha sa më sipër i rekomandon IAL-së se duhet që rregullorja e rekrutimit të citoj dhe bazohet në referenca të neneve të Statutit të IAL-së si dokumenti themelor i cili miratohet nga MASR, si edhe të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë". Gjithashtu të përcaktohet si kriter i detyrueshëm niveli</i></p>

	<i>minimal i mesatares për studimet bachelor dhe master të stafit akademik pa grada shkencore apo tituj.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	<p>GVJ gjatë vizitës në IAL evidentoi se, UE ka krijuar mjedise dhe mundësi shumë të përshtatshme për kryerjen e detyrave të personelit të Programit “Financë-Bankë”. Klasat ishin të pajisura me mjete dhe pajisje të nevojshme për zhvillimin e orëve mësimore. Në mjediset e IAL-së nuk mungonte sistemi ëireless i aksesueshëm për studentët për tu përdorë prej tyre në webs të nevojshëm për kërkim në funksion të procesit mësimor.</p> <p>Sipas kërkimit të kryer për punimet e PAE evidentohen disa arritje në fushën e kërkimit. Ky fakt mbështetet në numrin e kënaqshëm të artikujve të botuar si edhe pjesëmarrja në konferenca të organizuar brenda dhe jashtë vendit kryesisht nga PAE me grada dhe tituj të rekrutuar në vitet e fundit. Kualifikimi i personelit akademik në fushën e kërkimit ndihmon në përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	<p>UE gjatë 3 viteve të fundit ka organizuar rreth 2 trajnime për çdo vit akademik për PAE ku përfshihen edhe ata të Departamentit të Financë Bankë (DFB). Kryesisht, IAL nxit PAE-të të aplikojnë vet dhe fitojnë projekte të shkëmbimit të stafit Erasmus me Universitete të tjera partnere në Evropë dhe jashtë saj, me qëllim shkëmbim eksperiencash mësimore, shkencore dhe organizative. Nga RVB si edhe evidencat e paraqitura edhe gjatë vizitës në IAL nuk evidentohet përfshirja e PAE të DFB-së në projekte të fituara nga vet IAL.</p> <p><i>Zyra e projekteve në UE duhet të mbështes PAE-të e DFB në përfshirjen e tyre në projekte për më tepër kur PAE-të kanë ngarkesë mësimore të orëve në auditor në mbi 500 orë mësimore në çdo vit akademik.</i></p>



<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtjeshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>UE ka organizuar trajnime të PAE me fokus përmirësimin dhe zhvillimin profesional dhe trainimin akademik për arsimin digjital. Sipas RVB-së, në kuadër të përmirësimit të veprimtarive mësimore dhe aktiviteteve kërkimore. Gjithashtu sipas evidencave të depozituara nga IAL në sistemin e ASCAL, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të cilësis ka organizuar një aktivitet trajnimi për PAE-të sipas (<i>Evidencës 109</i>) “Academic Training on Digital Education”.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>GVJ konstaton se bazuar në Evidencën 25 (<i>Tabela 4, për ngarkesën e stafit akademik</i>) evidentohet se ndarja e ngarkesës mësimore për secilin anëtar të stafit akademik ka një shpërndarje dukshëm mbi normat e orëve mësimore të përcaktuara në VKM nr. 41, datë 24.01.2018, e ndryshuar. Kjo ngarkesë pune ndikon në cilësinë e punës së PAE për përmbushjen e objektivave të këtij program studimi.</p> <p>Sipas (<i>Evidencës 25</i>) dhe RVB-së evidentohen se PAE të DFB-së të përfshirë në këtë program studimi kanë ngarkesë të madhe orësh mësimore në auditor me përgjithësisht mbi 450 orë (<i>Tabela 4, Evidenca 25, Anekset e RVB-së</i>) dhe raste me mbi 550 apo 600 orë mësimore në auditor kryesisht për PAE dhe PAK pa grada shkencore apo tituj duke qenë se edhe pagesa për këtë kategori është dukshëm më e ulët krahasuar me PAE dhe PAK me tituj.</p> <p><i>GVJ konstaton se ka mbingarkesë orësh mësimore maksimale për stafin akademik të angazhuar në këtë program. Kjo nuk siguron cilësi të punës së stafit akademik dhe mundësi për të pasur kohë dhe përkushtim për kërkim dhe projekte shkencor prej tyre, pasi ngarkesa e tyre mësimore është shumë e madhe.</i></p> <p><i>GVJ rekomandon marrjen e masave për lehtësimin e ngarkesës me orë mësimore të PAE me qëllim që ata të kenë kohën dhe energjinë e nevojshme për kërkim shkencor, pjesëmarrje në projekte kërkimore ku mund të gjenerojnë të ardhura shtesë për veten dhe Universitetin si edhe më shumë angazhim me studentin.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>GVJ referuar vizitës dhe raporteve vjetore të IAL-së evidenton se</p> <p>UE ushtron veprimtarinë në kushtet e një kampusi universitar pavarisht se kapacitetet në këtë kampus nuk janë për të përballuar të gjithë studentët e regjistruar.</p> <p>Infrastruktura mësimore, shkencore, dhe e shërbimeve mbështetëse ofrojnë komoditet për studnetët dhe stafin e këtij programi mësimor. Në kampus ka ambiente në shërbim të mësimit si bibliotekë, sallë interneti, si dhe ambiente çlodhëse për studentët si mensë, kafeteri, etj.</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Në Kampusin e UE në funksion të zhvillimit të mësimit për këtë program studimi janë disa salla leksionësh, konferencash dhe 2 laboratorë kompjuterash të paisur me programe të përshtatura me lëndët e këtij programi studimi si Aplha dhe Financa 5. Por gjithashtu sipas GVB-së në laboratore janë të instaluar edhe MS Office, SAP2000, ETABS, .Net Visual Studio C ++, Matlab, GNS3 fundit, Multisim 11, VMËare Ëorkstation, MySQL \ Workbench, Eclipse, Python (x, y), Rhinoceros 4 SR8 + -MAX, SPSS, EVieës, etj.</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	
<p>Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.</p>	<p>GVJ referuar RVB-së dhe konstatimit nga vizitat në institucion shprehet se IAL disponon laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës specifike të disa prej lëndëve të planit mësimor të programit Financë Banke dhe sidomos ato përdoren për lëndët e “Statistikës” dhe “Ekonometrisë”.</p>



<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</p>	<p>Ndërsa lidhur me praktikën profesionale ky program studimi nuk e ka ende atë të detyruar në planin e tij mësimor. Ky detyrim do të filloj nga viti ardhshëm akademik sipas përgjigjeve të dhëna nga stafi IAL-së gjatë vizitës në institucion. Për mosplotësimin ende të këtij rekomandimi të dhënë nga Bordi ASCAL, GVJ është shprehur në një tjetër fushë të këtij raporti.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi IV.4 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sipas RVB, biblioteka e UE është në dispozicion për të gjithë studentët bachelor / master / doktoratë, akademikë dhe staf administrativ me kapacitetin e saj 100-vendësh, sipërfaqe prej 400 metrash katrorë, 25000 libra të shtypur dhe 2000 revista akademike digjitale e cila pasurohet vazhdimisht bazuar në kërkesat e stafit dhe studentëve.</p>
<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Sipas RVB, kjo IAL siguron stafit akademik dhe studentëve akses në një gamë të gjerë të revistave shkencore në gjuhë të huaj si: baza e të dhënave JSTOR, Cambridge Journals Online, IOPscience, New England Journal of Medicine, OECD-iLibrary, Taylor dhe Francis Library. Literatura e bibliotekës për çdo vit ka shtesa në tituj përmes blerjeve dhe dhurimeve të literaturës.</p> <p><i>Gjatë vizitës në IAL, meqënëse në RVB nuk ka evidencë ju kërkua të sjellin evidencë për fondin dhe titujt që ka shpenzuar IAL për pasurimin e bibliotekës në këto 3 vitet e fundit me tituj në gjuhën shqipe në zbatim të rekomandimit të dhënë nga Bordi ASCAL. Evidenca e dërguara pas vizitës në IAL nuk ka evidencë për fondin e shpenzuar në këto 3 vitet e fundit për shtimin e inventarit të titujve në shqip në bibliotekë por është veçse kërkesa e ish drejtuesit të departamentit për</i></p>

	<p><i>tu shtuar titujt por që nuk është mbështet më tej nga drejtuesit e IAL-së.</i></p> <p><i>Rekomandohet: IAL të marrë masa menjëherë për pasurimin e bibliotekës me literaturë në gjuhën shqip për studentët e programit Financë Bankë në Shqip.</i></p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>IAL ju mundëson të gjithë studentëve të këtij programi akses në literaturë përmes lidhjes në link të http://lib.EPOKA.edu.al/ si edhe tek JSTOR, etj ku mund të gjendet literaturë e mjaftueshme në gjuhë të huaj për fushën e studimit Financë Bankë. Ky akses mundësohet pa pagesë dhe në mënyrë të barabartë për çdo student të UE përmes adresës personale të çdo studenti te UE.</p>			
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në ambjentet e bibliotekës ku zakonisht shkojnë studentët dhe stafi akademik i këtij programi evidentoi se biblioteka ishte e pajisur me kompjutera dhe akses në internet dhe kushte kondicionimi dhe aspirimi pasi është e lidhur me ambjentet e përgjithshme të Kampusit.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Sipas RVB-së, koleksioni i bibliotekës pasurohet sipas kërkesave të stafit dhe studentëve të këtij programi por jo bazuar në një plan të detajuar.</p> <p>Për plotësimin e këtij kriteri gjatë vizitës në IAL u kërkua të sjellin evidencë për fondin që ka shpenzuar IAL për pasurimin e bibliotekës në këto 3 vitet e fundit dhe nëse kanë një plan të tillë. Nuk u dërgua asnjë evidencë e tillë me dokumentat shtesë pas vizitës.</p>			
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>GVJ u bë me dije se biblioteka e përdorur nga studentët e këtij programi është e hapur për studentët nga e Hënë në të Premte sipas orareve 08:30 - 12:30 dhe 13:30 - 19:30. Ndërsa ditën e Shtunë është e hapur nga ora 09:00 deri në orën 13:00.</p> <p>GVJ duke vlerësuar mundësinë e mirë që ka UE si një kampus universitar rekomandon zgjatjen e orarit të bibliotekës për çdo ditë të javës deri në orën 22:00.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Referuar RVB-së dhe evidentimit në vend gjatë vizitës konstatohet se Sistemi Interaktiv EPOKA (EIS) është sistemi kryesor i brendshëm i administrimit institucional. EIS përmban informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e këtij programi studimi.</p> <p>Meqënëse EIS është zhvilluar nga UE për të menaxhuar të gjitha informacionet që lidhen me studentët dhe veprimtarinë e tyre nga viti i parë i regjistrimit deri në diplomimin e tyre, nga GVJ u kërkua çertifikimi i sigurisë së këtij sistemi dhe kush kujdeset për auditimin e tij dhe ku ruhen të dhënat në rast të një situatë krize. Përgjigjet e marra nuk arritën të ezaurojnë çështjet e ngritura si edhe u shprehën se nuk kishte qenë e nevojshme të kryeshin certifikime dhe kontroll i sigurisë së sistemit.</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p><i>GVJ vlerëson si të pamjaftueshme argumentat e mësipërme sidomos pas pandemisë së COVID 19, kur IAL-të për kryerjen e veprimtarisë së tyre po lëvizin shpejt drejt mbështetjes së plotë në sistemet e informacionit. Si rrjedhim, GVJ rekomandon IAL-së:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • të marrë masa për certifikimin e sigurisë së EIS si edhe ta vendosi në planet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm këtë veprimtari; • të krijoj plane rikuperimi dhe ruajtje të të dhënave të sistemit në raste katastrofash.
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sipas RVB-së, EIS është një sistem interaktiv online i përdorshëm nga çdo student apo staf i UE përmes regjistrimit të llogarisë zyrtare të tyre në UE. Në EIS, studentët mund të përdorin informacionin e tyre personal dhe informacionin në lidhje me programin e tyre të studimit. Po ashtu edhe PAE dhe PAK kanë akses në lëndët e tyre. Stafit administrativ dhe ndihmës si administratorët e fakulteteve, zyra e BNJ dhe ajo e Financës, si edhe zyrat e pranimeve, e regjistrimit, e financës kanë të drejtat e tyre dhe fushat përkatëse për akses në EIS për të menaxhuar dokumentet studentëve, stafit dhe informacione të tjera të nevojshme.</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Përmes EIS, studentët mund të hyjnë në kurrikulën e programit, transkriptin, kërkesat dhe njoftimet e dhëna nga pedagogët apo</p>

<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>stafi administrativ. Pedagogët mund të përditësojnë programet e lëndëve, frekuentimin e studentëve, të caktojnë dhe të finalizojnë notat në sistem, etj.</p> <p>Ndërsa sipas RVB-së, Sistemi i Menaxhimit të Mësimi (LMS) - është një tjetër sistem shërbim, i bazuar në Moodle, i ofruar për studentët dhe pedagogët me qëllim aksesin, koordinimin dhe organizimin e materialeve të lëndës në internet. Ndërsa, IAL është ende duke punuar në faqen e internetit për të vënë në dispozicion informacionin në Gjuhën Shqipe.</p>			
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p><i>GVJ konstaton se informacioni që lidhet me këtë program studimi, personelin akademik të DFB dhe aktivitetet e ndryshme të tyre janë të publikuara vetëm në anglisht në faqen e internetit. Pra kemi mos plotësim të kërkesave të këtij kriteri.</i></p> <p><i>GVJ rekomandon, të merren masa urgjente për publikimin në shqip të të gjithë informacioneve që lidhen me këtë program studimi, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme që kryhen nga DFB dhe studentët e këtij programi studimi.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Standardi IV.6</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p><i>GVB lidhur me këto kriteret nuk ka të evidentuar sesa janë kostot në shifra për këtë program studimi dhe planin për mbështetjen e tyre. Gjithashtu, GVB në përgjigje të kriterëve të kësaj fushe nuk ka sjellë evidencë zyrtare me shifra dhe fakte për të parë plotësimin e kriterëve të këtij standardi.</i></p> <p>Në RVB, në evidencat e depozituara në sistemin e ASCAL por edhe gjatë vizitës në IAL nuk u shprehen nëse UE harton një raport financiar të kostove dhe një plan financiar të dedikuar për këtë program studimi. Kjo vërtetohet edhe me mungesën e dërgimit të evidencave të kërkuara pas vizitës në IAL ku u kërkuar të depozitohen evidencat e raporteve, dhe planeve për përdorimin e fondeve të arkëtuara nga tarifat e studentëve të këtij programi në funksion të pagesës së pedagogëve, pasurimit të literaturës, etj.</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit,</p>	

<p>shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Mungesa e evidencave përsa më sipër tregon se kjo IAL aplikon organizimin dhe planifikimin e centralizuar të punës nga lart-poshtë dhe mos lënien hapësirë për analiza në nivel të njësisë bazë e cila ka edhe përgjegjësinë e administrimit të këtij programi studimi.</p> <p><i>GVJ rekomandon, përfshirjen menjëherë të DFB-së në kryerjen e analizës së kostos së këtij programi studimi me qëllim kryerjen e analizave të nevojshme për mirëmenaxhimin e fondeve të marra nga tarifat e studentëve. Gjithashtu, përfshirje të DFB në ndërtimin e planit për mbështetjen financiare i cili duhet të kujdeset sidomos për motivimin dhe mbështetjen e PAE dhe PAK, stafit mbështetës, praktikave të studentëve, pasurimin e literaturës dhe shërbimet e tjera të nevojshme në funksion të realizimit të këtij programi studimi.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Referuar RVB-së, nuk evidentohet që UE të ketë Njësi të Auditimit të Brendshëm në zbatim të nenit 116 të Ligjit Nr. 80/2015 për “Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, por mbi këtë IAL aplikohet auditim vjetor i brendshëm nga Drejtoria e Përgjithshme e “Turgut Ozal Education” sh.a. dhe jo nga vet Universiteti “EPOKA”.</p> <p>Gjithashtu, referuar RVB-së “Turgut Ozal Education” sh.a. zhvillon një auditim të jashtëm vjetor në lidhje me situatën financiare të tij por jo të Universitetit “EPOKA”. Sipas RVB-së, raporti audituesit të jashtëm përmban të gjitha analizat e të dhënave mbi shpenzimet dhe të ardhurat e kompanisë dhe institucioneve të përfshira, të gjitha hyrjet që lidhen me të ardhurat (grante, tarifat e studentëve) dhe të gjitha shpenzimet për shërbimet që ofron drejtpërdrejt ose indirekt nga kompanitë e jashtme, por vetëm një kopje e auditimit vjetor gjendet në Zyrën e Financave të Universitetit “EPOKA” dhe kjo kopje nuk është bërë e aksesueshme në RVB apo për GVJ-në.</p> <p><i>GVJ i rekomandon IAL-së ngritjen dhe vendosjen në funksionim menjëherë të Departamentit të Auditimit të Brendshëm për këtë IAL, si edhe kryerjen dhe publikimin e raportit vjetor të auditimit të brendshëm për vetë Universitetin “EPOKA” të veçantë nga ai i “Turgut Ozal Education” sh.a i cili i kërkon për efekt konsolidimi financiar.</i></p>
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike</p>	<p><i>Përgjigja e dhënë nga GVB nuk i jep përgjigje kriterit 4, kjo vjen si pasojë e mos pasjes së analizave dhe raporteve financiare për këtë program studimi dhe të vetë Universitetit “EPOKA”.</i></p>

dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	<i>GVJ bazuar në raportin vjetor të 2018-2019 të publikuar të IAL-së për plan buxhetin e vitit akademik 2019-2020 krahasuar me vitin e mëparshëm evidentohen rritje në vlerë të të ardhurave nga tarifatat e studentëve dhe në të njëjtën kohë ulje në vlerë të shpenzimeve për stafin dhe kërkim zhvillimin. Kjo përqasje nuk ndihmon rritjen e cilësisë së studimit në këtë program studimi.</i>			
Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
IV			X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me	UE është kujdesur të hartojë dhe zbatojë rregullore dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015, dhe udhëzimin e MASR, Nr. 10, datë 15.05.2019 si edhe Udhëzimin e MASR, Nr. 17, datë 30.07.2019 për pranimin e studentëve në dalje, në përputhje me

legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	programin e ciklit të parë të studimeve Bachelor në “Financë Bankë” (shqip).
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Konkretisht për pranimet në këtë cikël studimi, të gjithë kandidatët që dëshirojnë të regjistrohen duhet të plotësojnë kriteret përkatëse të pranimit dhe të ndjekin procedurën e regjistrimit të publikuar në anglisht nga UE në http://admissions.epoka.edu.al/home-enrollment-procedure-1923-1925.html .
Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Sipas RVB-së, UE për çdo vit akademik ndjek udhëzimet e MASR dhe mundëson që kandidatët të zgjedhin programin e studimit që duan të regjistrohen përmes plotësimit të Formularit të Aplikimit në Portalin e Maturës Shtetërore të Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH) sipas link: https://ualbania.al/ . Më pas UE shpall listën paraprake dhe pastaj atë përfundimtare të fituesve për secilin program studimi. Kandidatët mund të kryejnë vetë regjistrimin përfundimtar ose përmes një personi të autorizuar me dokumentin e regjistrimit.
Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t’u pranuar në ciklin e parë të studimeve.	Gjithashtu, UE ka kuota të miratuara nga MASR për pranimin në këtë program studimi të kandidatëve nga vende të tjera. Ata duhet të plotësojnë kriteret e pranimit dhe ndjekin procedurën e regjistrimit.
Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	Për tu evidentuar është edhe konstatimi i kryer në verifikim e bërë në web të UE-së ku gjenden të publikuara kriteret dhe procedurat që kanë të bëjnë me: pranimin, përzgjedhjen e studentëve, përparimin përgjatë kursit të studimit, transferimin, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit për cilindo prej studentëve që ndjek ciklin e parë të studimeve Bachelor në “Financë Bankë”.
Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	GVJ konstaton se UE është kujdesur plotësisht për hartimin dhe zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi për kriteret e përgjithshme dhe ato specifike të pranimit të studentëve në programin e ciklit të parë të studimeve Bachelor në “Financë Bankë”. Konkretisht veprimtaria kryhet në përputhje me VKM mbi përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve (VKM 295, datë 10.05.2019) si edhe Ligjin Nr. 80/2015, Udhëzimet e MASR, vendimet e Senatit Akademik të UE, etj.



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>GVJ ka evidentuar edhe më herët në këtë RVJ, se UE ka një praktikë për tu vlerësuar pozitivisht përmes përdorimit të sistemit informativ EIS i cili mundëson studentëve akses të plotë mbi procedurat e përparimit akademik të tyre.</p> <p>GVJ konstaton se UE ka miratuar në rregulloret e tij si dhe në rregulloren e programit të studimit Bachelor në “Financë Bankë” kriteret dhe procedurat e njohjes së krediteve të mundshme nga kualifikimet e mëparshme ose studimet e pjesshme si edhe transferimin e tyre në këtë program mësimor. Konstatohet se të gjithë studentët e interesuar mund ta gjejnë lehtësisht këtë informacion në website të UE-së <i>me të vetmen vrejje të evidentuar edhe më herët që kjo IAL kuadrin e saj rregullator e ka vetëm në anglisht dhe jo në shqip.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Transferimet lejohen brenda të njëjtit cikël studimi dhe në fusha studimi të njëjta ose të përafërta dhe vetëm në fillim të vitit akademik. Konkretisht u evidentua se në fillim të çdo viti akademik, DFB ngre një komision ad-hoc për njohjen e lëndëve dhe krediteve respektive bazuar në dokumentacionin e përcjellë nga sekretaria mësimore për studentët e interesuar.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në IAL evidenton se DFB në çdo fillim semestri për çdo vit akademik shpall në ambiente publike orarin mësimor: ditën, orën, sallën dhe personelin akademik përkatës, për çdo semestër.</p> <p>Gjithashtu, programi (syllabusi) i çdo lënde mësimore ka të përcaktuar kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve. Këto ju prezantohen studentëve në orën e parë të mësimit nga pedagogu i lëndës. Gjithashtu, këto informacione studentët mund ti marrin edhe përmes ëbsite të UE-së si edhe në sistemin EIS dhe pranë sekretarisë mësimore nëse do ta gjykojnë të nevojshme.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve</p>	

të ardhshëm mbi programin e studimit.	GVJ konstaton se UE ka miratuar në rregulloren e tij, si edhe në rregulloren e këtij programi studimi të gjitha kriteret e procedurat për kryerjen e punimit të diplomës dhe diplomimin në programin e studimit Bachelor në “Financë Bankë”(shqip).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Sipas RVB-së, para fillimit të çdo semestri, të gjithë pedagogëve u kërkohet të ngarkojnë në sistem programin lëndor (syllabusin), i cili përmban informacione rreth planit të studimit, metodës së vlerësimit dhe materialeve të lëndës. Të gjitha programet mësimore gjenden online dhe janë të aksesueshme për studentët.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Referuar përgjigjes së RVB-së për kriterin 3 konstatohet se lista e mundësive për karrierë për të diplomuarit e programit të studimit Bachelor në “Financë Bankë” është e paqartë dhe përmban element promociional larg realitetit dhe konkretisht në këtë listë përfshihen mundësitë për një të sapo diplomuar në programin bachelor të mund të punojnë si: Menaxher Financiar, Menaxher i Bankës Ndërkombëtare, Broker i aksioneve, Konsulent, Analist financiar, Inspektor Financiar, Specialist i Tregtisë Ndërkombëtare, Analist kredie, Ndërmjetësi / tregtari, CFO, Zyrtari i huasë, Menaxheri i Buxhetit dhe Kostos, Tregtari financiar, Thesari i korporatës.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	Ndërkohë që në realitet studentët që ishin në vitin e tretë të studimit në këtë program e kishin kuptuar se një i sapo diplomuar mund të punësohet vetëm si arkëtar në një bankë tregtare apo specialist fillestar në zyrën e finacës në një biznes ne Shqipëri. Rritja jo reale e pritshmërive krijon konfuzion tëk aplikantët, familjarët e tyre dhe studentët e këtij programi studimi.
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	<i>GVJ rekomandon rishikim të listës së publikuar të mundësive të pozicioneve të punës për tu punësuar të sapo diplomuarve të këtij programi studimi duke qenë pranë realitetit e cila</i>

Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.

evidentohet përmes ndjekjes nga zyra e ALUMNI të punësimit të sapodiplomuarve në këtë programe studimi. Kjo listë e përditësuar mund të bëhet pjesë e Manualit udhëzues apo e guidës së studentëve të rekomanduar nga GVJ në standardin 1, kriteri 3, fusha 3.

GVJ referuar RVB-së dhe vizitës në IAL evidenton se UE ka aplikuar si praktikë të marrë nga Universitetet Turke një strukturë të quajtur Dekani i Studentëve i cili është nën varësi të Administratorit të IAL-së dhe përveç të tjerash ka nën varësi edhe zyrën e Planifikimit të Karrierës dhe Studentëve të Diplomuar (ZPKSD). Kjo zyrë në bashkëpunim me Departamentin e Financë Bankë mban lidhje me organizatat publike dhe private dhe bizneset me qëllim orientimin e studentëve drejt tregut të punës. Dekani studentëve përveçse kujdeset për orientimin dhe nevojat e studentëve në ambjentet e tjera të kampusit, kjo strukturë dhe zyrat e tij presin edhe shqetësimet e studentëve për aktivitete shkollore dhe kujdeset për zgjidhjen e tyre.

GVJ konstaton se nuk kuptohet deri në çfarë mase përgjegjësitë dhe kompetencat e Dekanit të Studentëve ndikojnë mbi veprimtarinë akademike të PAE dhe PAK si edhe drejtuesit e tyre.

GVJ këshillon trajtimin me kujdes të ndarjes së kompetencave dhe influencave të Dekanit të Studentëve (i cili ka varësi të drejtëpërdrejtë nga administratori i IAL-së) nga veprimtaria akademike.

Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Studentëve të Diplomuar (ZPKSD) bazuar në pyetësorë për të diplomuarit e UE ka përgatit raporte për drejtuesit e IAL-së. Raportet e vendosur me link në RVB nuk shprehinin qartë ç'pjesë e të intervistuarve ishin të diplomuar në programin e ciklit të parë dhe sa ishin të ciklit të dytë. Megjithatë, nga raporti u evidentua një gjetje ku 16% e të intervistuarve mendonin se njohuritë e marra në Universitetin Epoka nuk ishin të përdorshme në punën e tyre aktuale, ndërsa 22.6% e tyre ishin neutral për këtë pyetje, por pa u shprehur pozitivisht për njohuritë e marra, ndryshe nga pjesa tjetër e të intervistuarve.

GVJ gjatë vizitës në IAL pyeti se çfarë ka bërë IAL për të adresuar këtë gjetje. Përgjigje ishte se IAL kishte marrë masa duke biseduar me pedagogët për pakënaqësitë e studentëve apo ish studentëve ndaj tyre. Nga studentët u tha se dhe kishte pasë raste të marrjes së masave të largimit të një pedagogu të angazhuar në mësimdhënie.

	Gjatë vizitës në IAL, studentët e pyetur nga GVJ lidhur me kriterin 5, të këtij standardi, u shprehën pozitivisht për aksesin në dhe mundësitë që UE ju ka ofruar për tu informuar lehtësisht edhe në distancë përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit EIS. Studentët kanë akses në informacionin e tyre personal dhe informacionin që lidhet me programin e tyre të studimit duke mundësuar rregjistrimin e lëndës përmes sistemit, kontrollin e statusit të tyre akademik në lëndët e regjistruara gjatë semestrit, datat e provimeve, notat e ndërmjetme dhe notat përfundimtare. Përmes EIS, studentët shikojnë kurrikulën e programit, transkriptet, llogaritjen e notave, programin javor, kërkesat dhe njoftimet, etj.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.	GVJ gjatë vizitës në IAL, kërkoi të verifikojë ato çfarë evidentoheshin në RVB, se sekretaria mësimore e DFK disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. GVJ konstatoi se të dhëna e cituara më sipër ruhen në formë të shkruar (hard copy) si dhe në formë elektronike.
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Sipas takimeve të kryera gjatë vizitës në IAL nga GVJ në sekretarinë mësimore u konstatua se numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi për tre vitet e fundit akademike ishte: Viti 2017-2018, kuota 60, të rregjistruar 20, nga ku 2 të larguar; Viti 2018-2019, kuota 50, të rregjistruar 22, nga ku 3 të transferuar; Viti 2019-2020, kuota 50, të rregjistruar 29.
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë	



zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.	Sekretaria kujdesej të zbatontë nenin 101 të Ligjit të Arsimit të Lartë 80/15 duke regjistruar arritjet akademike në formë të shkruar dhe elektronike të gjithë studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi e deri në diplomimin e tyre.			
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Përveç formës tradicionale të shkrimit në regjistrat përkatës, të dhënat statistikore të studentëve të programit mësimor të ciklit të parë “Bachelor” në UE menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit EIS në formë elektronike. <i>GVJ është shprehur me rekomandim më herët në këtë raport lidhur me sigurinë dhe certifikimin e sistemeve të informacionit të përdorur nga UE dhe ruajtjen e të dhënave në raste katastrofash.</i>			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Sekretaria mësimore dhe zyrat e tjera që kanë akses në këto të dhëna kujdesen të ruajnë dhe përpunojnë të dhënat personale të studentëve bazuar në parimin e kofidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale. Në evidencat e paraqitura shikohet se IAL ka hartuar raport analitik mbi cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe punësimit të tyre, por nuk evidentohet të kenë një analizë për shkallën e cilësisë së punësimit të tyre dhe masat që duhen marrë në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve	Referuar RVB-së, UE ashtu si çdo IAL tjetër në zbatim të nenit 98 dhe 99 të Ligjit Nr. 80, 2015, dhe statutit të UE ju garanton studentëve të drejtat të marrin pjesë në proceset e vendimmarrëse dhe këshilluese të UE-së. Konkretisht studentët e UE-së përfaqësohen në vendimmarrjen e strukturave drejtuese të UE përmes përfaqësuesit të tyre të



ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	<p>zgjedhur bazuar në nenet 15, 16, 29, 34 dhe 35 të Statutit të Universitetit EPOKA për në Senatin Akademik, Këshillin e Etikës, Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë dhe në Komisionin e Përhershëm për Marrëdhëniet me Studentët. Përmes anëtarësimit të përfaqësuesve të studentëve të zgjedhur në Senatin Akademik, Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë dhe Këshilli i Etikës si dhe pjesëmarrjen aktive të këtyre përfaqësuesve të studentë në mbledhjet e këtyre organeve sigurohet përfshirja e studentëve në vendimmarrjen e çështjeve që i përkasin procesit akademik.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p><i>Në këtë IAL nuk evidentohet përfaqësimi i studentëve në Bordin e Administrimit të tij. Gjithashtu, gjatë vizitës në IAL, GVJ nga studentët e takuar evidentoi se ata nuk ishin të informuar për të drejtat e tyre sipas statutit të UE dhe të drejtën e përfaqësimit të tyre për të votuar në vendimmarrjen që bëhej në Senatin e UE apo Bord Administrimi. Gjithashtu, nuk njihnin kush prej studentëve i përfaqësonin në strukturat vendimmarrëse të UE.</i></p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjeshme të mëparshme.</p>	<p>Sipas evidencave të depozituara në sistemin e ASCAL dhe RVB-së, hartimi i programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Financë Bankë” është bërë në përputhje me bazë ligjore në fuqi për hapjen e programeve të Studimit, Udhëzimi i MAS Nr. 15, datë 04.04.2008. Ndryshimet, përmirësimet e këtij programi në vite janë bërë në referencë të ndryshimeve të bazës ligjore por jo bazuar në ndonjë studim tregu. Në RVB nuk evidentohet të jetë kthyer përgjigje për kriterin 4.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p><i>Ndërsa, GVJ nuk konstatoi tek evidencat asnjë raport apo analizë për rishikim të programit të studimit të ishte bërë në mbështetje të ndonjë propozimi nga studentët apo nga analiza e anketimit të tyre apo analiza e tregut (kujtojmë këtu se IAL nuk ka asnjë evidencë të këtë kryer vet studime tregu, ndërsa janë dhënë referenca për studiminin e tregut të punës në përgjithësi të kryera nga INSTAT në 2012 apo Banka Botërore në 2006, Evidenca 16). Gjithshtu, gjatë vizitës GVJ konstatoi sipas komenteve të studentëve nevojën e shprehur prej tyre edhe më herët për lidhjen e teorisë me praktikën dhe realitetin në Shqipëri ku ata jetojnë dhe mund të punësohen.</i></p>
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të</p>	<p>Referuar RVB-së, një muaj para periudhës së provimit përfundimtar për çdo semestër, studentët e këtij programi përmes EIS plotësojnë pyetësorin për vlerësimin e pedagogut dhe lëndës. Pas përfundimit të pyetësorit, sistemi elektronik tregon vlerësimin mesatar për çdo pedagog të lëndës, si një rezultat i përgjithshëm si dhe rezultatet për secilin komponent të pyetësorit, duke treguar renditjen e pedagogut të lëndës në</p>

<p>rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>bazë departamenti dhe fakulteti, si dhe komentet e dhëna nga studentët për çështje specifike. Këto raporte dhe analiza e kryer për gjetjet nuk janë përfshirë në RVB por as në evidencat e depozituara në sistemin e ASCAL duke lënë të kuptohet mos ndjekja dhe marrja e masave për adresimin e opinioneve të studentëve.</p> <p>Ndërsa, studentëve të këtij programi u mundësohej të kërkonin rishikim të vlerësimit (notës) së tyre brenda 1 jave përmes Zyrës së regjistrimit e cila është nën varësinë e Adminsitratorit të Fakultetit. Gjatë vizitës në IAL, GVJ mori si përgjigje nga punonjësit e Zyrës së regjistrimit se afërsisht 2 deri në 3 raste ankimimesh për rezultate provimesh kanë pasë për çdo semestër për këtë program studimi. Gjithashtu studentët e pyetur gjatë vizitës në IAL, u shprehën se nuk kanë pasur ankimim të rezultatit apo nevojën për rishikim.</p> <p><u>Në përfundim GVJ rekomandon IAL-së:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • të kryej një studim tregu për këtë program studimi dhe të konsideroj opinionet e marra nga ALUMNI dhe pyetësorët e studentëve për rishikimin e programit të studimit; • të përfshihen studentët me të drejtë vote në organet vendimarrëse të IAL-së dhe përfaqësuesit e tyre të zgjidhen me votim nga gjithë studentët duke siguruar njohjen dhe përfaqësimin e vërtet të tyre; 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi V.6</p>	
<p>Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>Në RVB nuk ka asnjë referencë apo evidencë të procedurave por evidentohet se Zyra e Regjistrimeve ndjek jetën akademike të studentëve nga regjistrimi deri në diplomim, mban të dhëna dhe evidenca sipas rregulloreve të UE.</p> <p>UE ka të angazhuara disa individë të cilët krahas punës si pedagog kryejnë edhe këshillimin, ndjekjen dhe përparimin e</p>

<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p> <p>Krahas Këshilltarit akademik, UE ju afron studentëve mundësinë e aksesit paralelisht edhe përmes Dekanit të studentëve, Administratorin e Fakultetit, etj. Konkretisht sipas RVB-së, zyra e dekanatit të studentëve është në komunikim të vazhdueshëm me studentët dhe pranon kërkesat e studentëve në baza ditore. Për çështje akademike kërkesa e studentit nga Dekani i Studentëve i dërgohet për trajtim departamenteve përkatëse, fakulteteve ose Zyrës së Rektorit. Pas vlerësimit të kërkesës, Koordinator i Zyrës së Dekanatit të Studentëve informon studentët për vendimin e kërkesës. Gjithashtu, sipas RVB-së, Dekani i Studentëve ju kërkon studentëve çdo fund semestri të plotësojnë një pyetësor për të mbledhur opinionet për përvojën dhe kënaqësinë e tyre në UE me qëllim të përputhjes së shërbimeve studentore të ofruara në UE.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p><i>Në evidencat e depozituara nga IAL nuk ka asnjë raport apo analizë të kryer nga Dekani i Studentëve dhe çfarë masash janë marrë nga IAL për të adresuar opinionet e studentëve të këtij programi studimi.</i></p> <p>Ndërsa, Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Studentëve të Diplomuar shërben për të orientuar studentët në gjetjen e fushave të mira të punës për ta dhe për të mbajtur dialogun e Universitetit me botën e biznesit.</p>			
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p><i>Në evidencat e depozituara nga IAL nuk ka asnjë raport apo analizë të kryer nga kjo zyrë lidhur me mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të këtij programi studimi si edhe masat e marra nga organet drejtuese të IAL-së pas raportimeve të bëra ng akjo zyrë.</i></p> <p><i>GVJ rekomandon se IAL dhe strukturat e saj respektive duhet realisht të merrin në analizë dhe konsideratë mendimet dhe opinionet e të diplomuarve që janë të punësuar apo kanë pretendime për ripozicionim të tyre me qëllim që opinionet e tyre për rishikim të programeve të studimit të reflektohen në rishikimin e tyre, apo në planet dhe syllabuse të lëndëve që ofrohen në UE.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	UE në zbatim të detyrimit të Ligjit të Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, ka hartuar politika si dhe ka ngritur struktura në funksion të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Referuar RVB-së, Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë, me nënnyjësitë e tij si Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Komisioni i Zhvillimit të Kurrikulave dhe Bordi i Provimeve përbëjnë sistemin e brendshëm të Sigurimit të Cilësisë të UE. Strukturat dhe parimet e funksionimit të Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë (SBSC) i ka vendosur edhe në nenet 35 dhe 37 të Statutit të UE, Rregulloren “Për Funksionimin e KPSC” dhe Manualin e Sigurimit të Cilësisë së UE. Gjithashtu, universiteti ka krijuar Politikën e Cilësisë që mbulon politikën në lidhje me parimet dhe standardet kryesore të sistemit të menaxhimit të cilësisë në përdorim në UE. Përmes Statutit është vendosur detyrimi i ngritjes së Komisioneve të Përhershme të Sigurimit të Cilësisë në nivel Institucioni për UE.
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	<i>GVJ konstaton se UE në përmbushje të politikave të përmendura më sipër ka ngritur strukturat për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë vetëm në nivel institucional dhe jo në nivel njësie kryesore dhe njësie bazë. Komisionit Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë ka në përbërjen e vet përfaqësim të studentëve dhe një ekspert të jashtëm. Por GVJ konstaton se anëtarëve të këtij komisioni ju ka mbaruar mandati prej disa muajsh me përjashtim të njërit prej tyre (referuar Statutit të</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që	

promovojnë e përmirësojnë cilësinë.	<i>UE dhe Tabelës 24, Evidenca 3) duke e bërë këtë IAL të jetë në mos respektim të kërkesave ligjore.</i>			
Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.	<i>Në përfundim, GVJ rekomandon IAL-së të marrë urgjent masat për zgjedhjen e 10 anëtarëve dhe kryetarit të Komisionit të përhershëm për Sigurimin e Cilësisë, me qëllim zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi për garantimin e përmirësimin të vazhdueshëm të cilësisë së programeve mësimore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.	Senati Akademik i Universitetit “EPOKA” ka ngritur Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë si edhe njësitë mbështetëse. Megjithatë në respekt të kuadrit ligjor, Senati Akademik i UE vlerëson, garanton dhe është përgjegjës për sigurimin e cilësisë në institucion, në përputhje me standardet shtetërore. Ndërsa përgjegjësia për funksionimin efektiv dhe eficient të këtij programi studimi dhe sigurimin e cilësisë së tij i përket DFB-së.
Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashërme të programeve të studimeve të ciklit të parë.	Referuar RVB-së, DFB për monitorimin dhe rishikimin e këtij programi studimit bazohet në rregulloren “Për përmirësimin e vazhdueshëm të programit studimit”. Propozimi i departamentit për përmirësimin e kurrikulës për programet e studimeve përkatëse fillimisht shqyrtohen nga Dekanati, vendimi i Dekanatit mbi propozimet për përmirësim të programit të studimit dërgohen në Komisionin e Zhvillimit të Kurrikulave, më pas propozimi për përmirësimin e
Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente	



matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	programeve të studimit dërgohen për shqyrtim në Komisionin e Përhershëm për Sigurimin të Cilësisë, më pas Senati Akademik merr vendimin përfundimtar mbi përmirësimin e programit të studimit.			
Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Megjithatë, <i>GVJ nuk konstatoi evidenca në RVB apo në sistemin e ASCAL të praktikave të aplikuara nga UE për ndjekjen e procedurave standarde dhe të dokumentuara për kryerjen e ndryshimeve në planet mësimore bazuar në raportet dhe analizat e vlerësimit të cilësisë së kryer nga kjo IAL.</i>			
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.	<p>GVJ vlerëson si praktikë të mirë që UE përthith opinionin e studentëve përmes pyetësorëve të shpërndarë në çdo fund semestri para provimit final me qëllim përmirësimin e programeve mësimore të ofruara nga UE. <i>Megjithatë, GVJ nuk konstatoi evidenca në RVB apo në sistemin e ASCAL të Analizave dhe masave të marra bazuar në gjetjet nga këta pyetësor.</i></p> <p><i>GVJ i rekomandon Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit të UE:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>të kërkojnë një analizë të vlerësimeve të kryera për këtë program studimi si edhe ndjekjen e masave të dhëna për adresimin e gjetjeve, mangësive dhe rekomandimeve të evidentuara nga këto raporte për përmirësimin në vijim të cilësisë.</i> • <i>DFB-së ti jepen të drejtat dhe detyrimet për përmirësimin dhe rishikimin e programit mësimor dhe si udhërrëfyes për këto ndryshime duhet të ketë rekomandimet e Bordit të ASCAL, studimin e tregut të punës dhe nevojat e tij, mendimet e marra prej studentëve, bizneseve, alumni, etj.</i> <p><i>Të gjitha këto rekomandohen me qëllim që studentët e diplomuar në këtë program të marrin dijet dhe njohuritë e nevojshme për tu integruar sa më shpejtë në tregun e punës.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.3

Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p><i>GVJ konstaton se në këtë standard ashtu si edhe në disa të tjera të kësaj fushe vlerësimi në RVB nuk janë dhënë përgjigje për atë çfarë kërkojnë kriteret, si edhe ka mungesë të theksuar të referencave dhe evidencave pavarësisht se sipas RVB-së së këtij program studimi, draft RVB-ja është dërguar edhe për opinion tek KPSC. Këtu risillet në vëmendje fakti se mandati i përfunduar i anëtarë të KPSC-së sjell mungesë angazhimi të kësaj strukture shumë të rëndësishme për sigurimin e cilësisë. Të gjitha sa më sipër e vendosin në vështirësi vlerësimin nga ana e GVJ-së.</i></p> <p>UE ka përgjegjësinë që t'i ofrojë studentëve të këtij programi studimi një cilësi të lartë të programit mësimor, të tregojë se po bën përpjekjet e duhura për të përdorur në mënyrë efektive dhe efikase burimet e siguruar nga tarifat e tyre, dhe të sigurojë që janë plotësuar standardet e cilësisë. Senati Akademik i UE-së si organi më i lartë akademik ka përgjegjësinë përfundimtare për miratimin, monitorimin dhe rishikimin e të gjitha procedurave të sigurimit të cilësisë në UE.</p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në IAL, përmes pyetje-përgjigjeve GVJ evidentoi se UE me qëllim rritjen e cilësisë ka përdorur disa metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit, të tilla si pyetësorët, vëzhgimin në auditor dhe vlerësim paralel të provimeve të studentëve.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndër-institucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p><i>GVJ vlerëson pozitivisht që UE për sigurimin e jashtëm të cilësisë ka marrë një vlerësim nga Evalag dhe ACCA për këtë program studimi. Por, raportet e tyre nuk gjenden si Evidenca në dokumentat e depozituar nga UE.</i></p> <p><i>GVJ i sugjeron IAL-së që përveç metodave që ai aplikon dhe atyre të cituara më herët nga GVJ mund të përdorë edhe metoda dhe instrumenta të tjera të standardizuara të cilat ndihmojnë vlerësimin dhe ndërtimin e qëndrueshëm të cilësisë së programit të studimit, të tilla si vlerësimi 360 gradë si një teknikë e aplikueshme për vlerësimin e eprorëve, kolegëve dhe vartësve në universitete. Si edhe fokus grupet me përfaqësues nga komuniteti biznesit në Shqipëri.</i></p>

<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi VI.4</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p><i>GVJ konstaton se në këtë standard ashtu si edhe në disa të tjera të kësaj fushe vlerësimi në RVB nuk janë dhënë përgjigje për atë çfarë kërkojnë kriteret por ka përsëritje të përgjigjeve, si edhe ka mungesë të referencave dhe evidencave. Të gjitha sa më sipër e vendosin në vështirësi vlerësimin nga ana e GVJ-së.</i></p> <p>Sipas Tabelës 24, Evidenca 1 ose 2, KPSC përbëhet nga 11 anëtar përfshirë edhe kryetarin, ndërsa sipas RVB-së shprehet se KPSC përbëhet nga të paktën tetë anëtarë, mes të cilëve një Kryetar, një anëtar i stafit akademik me kohë të plotë nga çdo njësi kryesore me të paktën gradën shkencore “Doktor” dhe pa detyra drejtuese të nivelit të lartë, të paktën dy anëtarë të stafit administrativ, një përfaqësues i të diplomuarve të Universitetit,</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë</p>	



<p>të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>si dhe një specialist i jashtëm me përvojë të çmuar në çështjet e sigurimit të cilësisë, të cilët zgjidhen nga Senati Akademik, për një periudhë dyvjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje. Me këtë kompozim UE ka mundur të përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>			
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sigurimi i cilësisë është një proces që përfshin disa struktura, palë dhe individë të cilët duhet të kenë detyra dhe përgjegjësi të ndara qartë, infrastrukturën e duhur, mandatin e qartë, si edhe pavarësinë për të plotësuar detyrat e tyre.</p> <p><i>GVJ si edhe më herët në këtë RVJ ka evidentuar mungesën e mandatimit të 10 nga 11 anëtarët e KPSC-së së UE ku pjesë e tyre mund të jenë PAE nga DFB apo edhe studentë të këtij programi studimi. Gjithashtu GVJ konstaton se pavarësisht sa është bërë këto vite, ka akoma për të bërë lidhur me përfshirjen më të gjerë të bashkëpunëtorëve dhe/ose ekspertë të jashtëm të cilët mund të japin ekspertizë të vyer në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>				
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyer në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi VI.5



Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p><i>Sipas RVB-së, Raportet e vlerësimit të jashtëm shqyrtohen nga drejtuesit dhe përgatitet një plan veprimi. Ndërkohë që kemi ende të pa plotësuara rekomandimet e dhëna nga Bordi Akreditimit nr. 76, datë 21.09.2017, "Për akreditimin periodik të programit të studimit të ciklit të parë, Bachelor në "Financë-Bankë" të Universitetit "EPOKA" për vendosjen e praktikës si lëndë e detyruar, KPSC dhe Senati Akademik nuk kanë plotësuar detyrimet e tyre për ndjekjen në zbatim të plotësisht të masave për rekomandimet e dhëna që prej vitit 2017.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p><i>GVJ konstaton se në këtë standard ashtu si edhe në disa të tjera në RVB-në e këtij programi studimi si edhe në sistem janë dhënë referenca jo të sakta, të cilat kur kërkon ti aksesosh nuk gjenden ato për çfarë janë cituar në RVB, është dhënë i gjithë dokumenti me dhjetra apo qindra faqe por asnjë specifikim se cili nen apo paragraf i përgjigjet kriterit, ka raste që janë dhënë dokumenta të cilat nuk janë aspak të nevojshme, etj. Duke përfshirë këtu edhe konstatimin e GVJ-se për vijimin e mos plotësisht të rekomandimit të Bordit të ASCAL nga IAL për vendosjen e dokumentacionit në gjuhën shqipe në websitin e tyre. Të gjitha këto çojnë në konstatimin për asimetri të informacionit dhe mungesë të transparencës për pretendentët.</i></p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p><i>Duke përfshirë këtu edhe konstatimin e GVJ-se për vijimin e mos plotësisht të rekomandimit të Bordit të ASCAL nga IAL për vendosjen e dokumentacionit në gjuhën shqipe në websitin e tyre. Të gjitha këto çojnë në konstatimin për asimetri të informacionit dhe mungesë të transparencës për pretendentët.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p><i>Në përfundim, GVJ i rekomandon IAL-së, të merren masat për:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Të siguruar përmbushjen plotësisht të rekomandimeve të dhëna me Vendimin e Bordit të Akreditimit nr. 77, datë 21.09.2017;</i> • <i>publikim të rezultateve të vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</i>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në: “Financë – Bankë (shqip)”

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Syllabuset e lëndëve të programit të studimit janë të organizuara në mënyrë të qartë dhe i ndihmojnë studentët të njohin paraprakisht rezultatet e të nxënit në cdo disiplinë mësimore;
2. Programi i studimit aplikon vlerësimin e vazhdueshëm gjatë vitit, çka lehtëson mësimnxënien dhe rezultate pozitive;
3. Institucioni ka hapësira të bollshme dhe në nivel të një kampusi të mirëorganizuar me të gjitha facilitetet e nevojshme për studentët;
4. Zotëron emër të mirë;
5. Institucioni është i angazhuar në përthithjen e fondeve nga projekte kombëtare dhe ndërkombëtare;
6. Për këtë program studimi ka të punësuar personel akademik me eksperiencë praktike nga fusha e studimit duke rritur shkallën e larmisë dhe ekspozimit të studentëve ndaj eksperiencave konkrete të aplikueshme në realitetin shqiptar;

b. Pika të dobta:

1. Materialet e postuara në website të IAL-së janë pothuajse të gjitha në gjuhën angleze;
2. Mungesë të një raport analize për rishikim të programit të studimit bazuar në propozime nga studentët, analiza e anketimit të tyre dhe ALUMNI, analiza e tregut (kujtojmë këtu se IAL nuk ka asnjë evidencë të këtë kryer vet studime tregu, ndërsa janë dhënë referenca për studimin e tregut të punës në përgjithësi të kryera nga INSTAT në 2012 apo Banka Botërore në 2006);
3. Kurrikula e programit të studimit është e ngarkuar me lëndë të karakterit kërkimor (Metoda Kërkimore, Ekonometri) çka është e panatyrshme për nivelin Bachelor. Gjithashtu kurrikula

është e bollshme me lëndë me zgjedhje por ndër të cilat vihet re se mungojnë lëndë me interes për këtë program studimi siç janë kontabiliteti i informatizuar, etika në profesion;

4. Mungesa e raportit financiar të kostove të programit të studimit dhe planit për mbështetjen financiare të tij;
5. Në RVB dhe website të IAL-së konstatohen disa aspekte me asimetri informacioni dhe mungesë të zbulimit (disclosure).
6. Literatura e detyrueshme në të gjitha programet lëndore është në gjuhën angleze dhe jo në gjuhën shqipe;

Rekomandime:

1. Të merren menjëherë masa për publikimin në shqip të të gjithë informacioneve në website të IAL-së. Të gjitha materialet që postohen duhet të jenë edhe në gjuhën shqipe;
2. Të kryej një studim tregu për këtë program studimi dhe të konsideroj opinionet e marra nga ALUMNI dhe pyetësorët e studentëve për rishikimin e programit të studimit;
3. Të zëvendësohen (brenda kufijve të lejuar) disa nga lëndët e karakterit kërkimor (Metoda Kërkimore, Ekonometri) me lëndë me interes për këtë program studimi sic janë: etika në profesion, kontabiliteti i informatizuar;
4. Të shihet mundësia e rishikimit të ngarkesës mësimore për të lehtësuar numrin e orëve për pedagogët, si edhe të sigurohet të mos ketë asnjë PAE/PAK pa zotëruar të paktën master shkencor për të qenë në përputhje me Ligjin 80/2015, Neni 59;
5. Rregullorja e rekrutimit të citoj dhe bazohet në referenca të neneve të Statutit të IAL-së si dokumenti themelor i cili miratohet nga MASR, si edhe të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", si edhe të ketë të përcaktuara si kriter i detyrueshëm nivelin minimal të mesatares për studimet bachelor dhe master shkencor për PAE/PAK të cilët nuk kanë gradë shkencore apo tituj;
6. Të axhornohen në vijimësi dosjet e PAE/PAK;
7. Të marrë masa të vendosi në planet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm auditimin e sistemit/ve dhe funksionimin e tij/re, si edhe hartimin dhe miratimin e planeve të rikuperimit në raste katastrofash;
8. Të kryejë analizë të kostove të këtij programi studimi dhe hartim të planit për mbështetjen financiare duke u kujdesur për një korrelacion të drejtë mes rritjes së të ardhurave dhe shpenzimeve për stafin akademik dhe kërkim zhvillimin;
9. Të krijojë dhe vendosë menjëherë në funksionim Departamentin e Auditimit të Brendshëm të vet IAL-së, i cili veprimtarinë e tij duhet ta pasqyrojë në raportin vjetor të auditimit të brendshëm dhe ta publikoj atë;
10. Senati Akademik të marrë menjëherë masat për zgjedhjen e 10 anëtarëve dhe kryetarit të Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë, me qëllim zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi për garantimin e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së këtij programi mësimor;

11. Të siguroj përmbushjen plotësisht të rekomandimeve të dhëna me Vendimin e Bordit të Akreditimit nr. 77, datë 21.09.2017, si edhe publikim të rezultateve të vlerësimeve të programit të studimit

Conclusions of the Evaluation of the study program of the first cycle Bachelor in "Banking and Finance (Albanian)"

a. Strengths and affirmations:

1. The syllabi of the study program courses are organized in a clear manner and are helpful to students so that they can know in advance the learning outcomes in each discipline;
2. The study program applies a continuous assessment approach throughout the year, which facilitates learning and positive outcomes on behalf of the students;
3. The institution has a well-organized campus with all necessary facilities for students;
4. The Institution possesses a positive image and brand name;
5. The institution is engaged in the absorption of funds from numerous national and international projects and benefits financially, logistically from these projects;
6. For this study program, the Institution has employed highly qualified and experienced academic staff, hence increasing the degree of diversity and exposure of students to different experiences of the Albanian economic context;

b. Weaknesses:

1. The materials posted on the website of this HEI are almost all in English;
2. Lack of an analysis report for review of the study program based on proposals from students, analysis of their survey and ALUMNI, market analysis (recalling that HEI has no evidence of having carried out market studies per se, while references are provided for the labor market study in general conducted by INSTAT in 2012 or the World Bank in 2006, Evidence 16);
3. The curriculum of the study program is overloaded with course modules of a research content such as Research Method, Econometrics which is well beyond the scope of the Bachelor level studies. Also the curriculum is abundant with elective courses but among which it is noticed that there are no courses of closer interest for this study program such as computerized accounting and programs and ethics in the profession;
4. Lack of financial report reporting the costs of the study program and the plan for its future financial support;
5. There are ascertained aspects with information asymmetry and lack of disclosure in the Internal Evaluation Report and the website of the HEI;
6. The required literature in all the program syllabi is in the English language, instead of the Albanian language;

Recommendations:

1. Take immediate measures for the publication of all information on the website of the HEI in the Albanian language;
2. Conduct a market study for this study program and consider the opinions received from Program's ALUMNI and the student questionnaires for the review of the study program;
3. Replace (within the allowed criteria) some of the modules with research character (Research Method, Econometrics) with subjects of interest for this study program such as: ethics in the profession and computerized accounting;
4. Consider the possibility of reviewing the teaching load for the full time staff as well as ensure that there is neither full time nor part time staff employed without having at least a degree in scientific master to be in accordance with Law 80/2015, Article 59;
5. The Recruitment Regulation of the HEI should quote and be based on references to the articles of the Statute of the HEI as the basic document which is approved by MASR, as well as Law no. 80/2015 "On Higher Education and Scientific Research in Higher Education Institutions in the Republic of Albania", as well as those defined as mandatory criteria, the minimum average level for bachelor and master studies for full time and part time staff who do not have scientific degrees or titles;
6. The HEI should continuously update the full time and part time staff files;
7. Take measures for safety certification of the Electronic system of the HEI – EIS, as well as include in the internal and external audit plans, the audit of the system and of its operation, as well as the design and approval of recovery plans in case of disasters;
8. Carry out a cost analysis of this study program and draft a plan for financial support with a special focus on the correlation between revenue growth and expenditure for academic staff and research development;
9. Establish and immediately put into effective operation the Internal Audit Department of this HEI, which should analyze the activities of the HEI in the Annual Internal Audit Report and publish this report;
10. The Academic Senate is to take immediate measures for the election of the 10 members and the chairman of the Standing Committee for Quality Assurance, so that this body can implement the legal and regulatory framework in force to ensure continuous improvement of the quality;
11. Ensure full compliance with the recommendations given by the Decision of the Accreditation Board no. 77, dated 21.09.2017, as well as the publication of the results of the evaluations of the study program;

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS
--------------------------------	---

	Niveli përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE			X	
VLERËSIMI TËRËSOR			X	

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Asoc. Dr. Artur RIBAJ

Prof. Asoc. Dr. Rezarta PERRI